

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7364 E shtunë 25 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Kjo javë është shpallur "Java e Kështjës së Sigurisë Rrugore" në kuadrin e ditës botërore të respektimit të viktimave nga aksidentet rrugore. Fatkeqësisht ...
Vijon në faqen 21

Nga FISNIK ZIÇISHTI

Për të mos vajtuar më



Reportazhi

Ditës

Nga DEUTSCHE WELLE



Së paku 235 njerëz janë vrarë nga një sulm me bombë dhe armë zjarri në një xhami në rajonin Sinai të Egjiptit. Mediat lokale thanë se sulmi ka ndodhur në qytetin ...
Vijon në faqen 21

Sulmi në xhami vret 230 myslimanë në Egjipt



Dyshimi, u lejuan që të arratisen në kufi

3 shefat e policisë në kërkim, ishin në Shqipëri kur dolën urdhër-arrestet

U "kap mat" në makinën e Habilajve, deputetja e PS u përvishet gazetarëve: Flas në prokurori

Nga INA ALLKANJARI

Pavarësisht lëshimit të urdhër-arresteve nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, për tre ish-zyrtarët e policisë së Vlorës, në kuadër të hetimit të dosjes "Habilaj", asnjë prej të kërkuarve nuk është gjetur ende. Burime pranë organit të akuzës konfirmojnë...
Në faqet 2-3

VENDIMI/ "ESKOBARI" I BALLKANIT AKUZOHEP PER TRAFIK NDERKOMBETAR DROGE

SEKUESTROHEN HOTELI DHE 36 SHTEPI TE BALILIT

45-vjeçari në kërkim, kompleksi luksoz në emër të familjarëve. Para 1 viti, Donald Lu tha: Kur s'kapni Klement Balilin, si mund t'ju marrim seriozisht?



(Në foto) Klement Balili. Hoteli "Santa Quaranta" pronë e Balilit

NGJARJA NE SHKODER

Pasagjerët: Si na terrorizuan tre maskat me kallashë te koka

Në faqen 8

FAMILJA NE KUÇOVE

Mes mjerimit dhe autizmit, dhimbja e një nëne: Nuk blej dot as ilaçe

Në faqen 12

INTERVISTA

Besim Zekthi, flet "Nderi i Kombit": Vallen e nisa që fëmijë nëpër dasma


Në faqet 10-11

FLET TRAJNERI

Ilir Daja: Shpërblimi për fitoren? Do blej një makinë të re

Në faqen 22

INTERVISTA



Kryemadhi: Rama po bllokon KLP për Prokurorin e Përgjithshëm

Në faqen 5

BLUE TRAJNERI

Festa e 30-vjetorit të portierit. Meta mbledh VIP-at për "Javën e Jetimëve"

Çiljeta, surpriza në ditëlindjen e Albanit

Hueyda El Saied, pas divorcit gjen dashurinë. Pirro Çako, ja lidhja e re

Nga PAMELA ALIAJ

Do të duhej ditëlindja e 30-të e Alban Hoxhës, që ai dhe Çiljeta të shfaqeshin në një fotografi së bashku. Prej gati dy vjetësh dyshja e mirënjohur është përfolur për një lidhje mes tyre, duke



u kapur shpesh nga paparacët në rrugët e kafenetë e Tiranës. Këngëtarja, por edhe portieri asnjëherë nuk kanë folur publikisht për lidhjen e tyre, duke e bërë edhe më konfuz publikun për marrëdhënien që kanë. Por duket se tashmë nuk ...

Suplement

DOSJA 'HABILAJ'

HETIMI

Dekonspirimi i operacionit për kapjen e 3 ish-zyrtarëve, Xhafaj kallëzim në prokurori

"Kur firmosëm urdhër-arrestet, 3 ish-policët ndodheshin në Shqipëri"

Prokuroria: U zhdukën paraditen e së mërkurës

Ina Allkanjari

Pavarësisht lëshimit të urdhër-arresteve nga prokuroria e krimeve të rënda, për tre ish-zyrtarët e policisë së Vlorës, në kuadër të hetimit të dosjes "Habilaj", asnjë prej të kërkuarve nuk është gjetur ende. Burime pranë organit të akuzës konfirmojnë se ish-zyrtarët e policisë ndodheshin në territorin shqiptar në momentin kur prokurorët firmosën urdhër-arrestet ndaj tyre, për këtë arsye policia dyshon se aksioni është dekonspiruar. Burimet pranë prokurorisë thanë se dispononin informacione të detajuara për vendndodhjen e tre ish-zyrtarëve, por prej paradites së të mërkurës ish-zyrtarët u zhdukën pa lënë gjurmë. Megjithatë prokuroria ka dyshime se 3 ish-zyrtarët fshihen ende në Shqipëri, pasi sipas të dhënave në sistemin TIMS, nuk rezultojnë të kenë dalë jashtë territorit. Ndërkohë, Drejtoria e Standardeve Profesionale ka nisur procedurat për përshtimin e tre efektiveve të kërkuar nga radhët e policisë, duke hapur rrugë shpalljes së tyre në kërkim ndërkombëtar. Për këtë rast ka nisur hetimet edhe Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme. Në datë 23 nëntor 2017 me kërkesë të drejtuesit të SHÇBA-së, prokurorët e çështjes dhe drejtuesi i Prokurorisë për Krime të Rënda, kanë zhvilluar një takim për të analizuar të gjitha veprimet procedurale të kryera dhe që do të kryhen në vijim, në kuadër të këtij hetimi. Mësohet se ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj depozitoi kallëzimin penal në prokurori për dekonspirimin e operacionit. Materiali kallëzues është nisur me postë dhe pritet të administrohet në prokurori, javën e ardhshme.

HETIMET
Ish-drejtori i policisë së



Jaeld Çela



Gjergj Kohila



Sokol Bode

KALLËZIMI

Ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj depozitoi kallëzimin penal në prokurori për dekonspirimin e operacionit. Materiali kallëzues është nisur me postë dhe pritet të administrohet në prokurori javën e ardhshme.

"Do shkoj në prokurori dhe do përgjigjem për çdo gjë"

Çështja "Habilaj", deputetja e PS gazetarëve: Mos vazhdoni lojën e kazanit

TIRANË- Ish-zëvendës ministrja e Brendshme, deputetja e PS-së Elona Gjebreka ka folur sërish sot para gazetarëve në lidhje me informacionet e publikuara se është thirrur nga prokuroria për t'u pyetur për çështjen "Habilaj". Gjebreka ka mohuar lajmet se ajo është thirrur në prokurori për t'u pyetur për këtë çështje. E rrethuar nga gazetarët, që kërkonin me ngulm një prononcim pas debateve në Komisionin e Sigurisë, Gjebreka u ka kërkuar të ruajnë etikën e të mos bëjnë prokurorin. "Në radhë të parë, përdorni etikën dhe mos



deputetja e PS-së Elona Gjebreka

vazhdoni lojën e kazanit, të manipuloni, të përdorni shpifjen. Ti moj vajzë nuk je prokurorë që të më pyesësh mua kështu. Unë do shkoj në prokurori dhe do përgjigjem

për çdo gjë. Jam fare e qetë. Nuk kam shkuar dhe jam e gatshme të shkoj në prokurori. Nuk më ka thirrur njeri akoma", -tha Gjebreka.

Vlorës, Jaeld Çela, ish-shëf i Krimit të Organizuar, Gjergj Kohila dhe ish-shëf i Postës Kufitare të Dhërmiut dyshohet të jenë larguar jashtë vendit. Gjatë kontrollit në banesat dhe ambientet ku qëndronin tre ish-zyrtarët, nuk u bë e mundur gjetja dhe arrestimi i tyre nga poli-

cia, ky fakt ngriti dyshime të forta se operacioni është dekonspiruar. Organi i akuzës ka nisur hetimet mbi zyrtarë të tjerë që kanë akses në informacion dhe mund të kenë informuar të dyshuarit që të largoheshin. Masa e ndalimit ndaj tre ish-zyrtarëve është dhënë pasi

akuzohen për mosveprim ndaj kultivimit të kanabis sativës në këtë qark, duke lejuar trafikimin e drogës së Habilajve në drejtim të Italisë. Për përfshirje në këtë grup kriminal, më herët Prokuroria e Krimeve të Rënda ka kërkuar nga parlamenti autorizim për heqjen



Sokol Bode Moisi Habilaj (në rreth)

DEKONSPIRIMI I AKSIONIT

Pas lëshimit të urdhër-arresteve për tre ish-zyrtarët, Prokuroria e Krimeve të Rënda ka nisur hetimet mbi zyrtarë të tjerë që kanë akses në informacion dhe mund të kenë informuar të dyshuarit që të largoheshin, duke dekonspiruar aksionin.

PROKURORIA

Grabitja e Rinasit, refuzohet kërkesa e Aleksandër Murataj

Këtë të premte Aleksandër Murataj, anëtar i dyshuar i bandës që grabiste blindat me para në aksin Qafë Kashar-Rinas, kërkoj nga Gjykata e Krimeve të lirë. Murataj kërkon lirinë me argumentin se mbahet në burg pa prova, por kjo kërkesë e tij u rrëzua. 41-vjeçari u prangos më 14 mars 2017 ndërsa prej 9 muaj qëndron në qeli me akuzën e grupit të strukturuar kriminal, grabitjes me armë e dhunë si dhe armëmbajtjes pa leje. Më 9 shkurt 2017 u godit eskorta që transportonte paratë e një banke të nivelit të dytë drejt Rinasit dhe në të u grabitën mbi 3.3 milionë euro. Sipas akuzës Aleksandër Murataj është pjesë e një grupi kriminal që drejtohej nga vëllai i tij Admir Murataj për të cilin i është kërkuar ndihmë dhe Interpolit për ta arrestuar pasi dyshohet se fshihet jashtë vendit. Prokuroria pretendon se Murataj, së bashku me 8 persona të tjerë janë autorët e dy grabitjeve në aksin Qafë Kashar-Rinas dhe kanë mundur të marrin nën kërcënimin e armëve mbi 10 milionë euro, ndërkohë gjatë arrestimit të pjesëtarëve të bandës janë sekuestruar më pak se 1 milion euro dhe për paratë e tjera s'ka ende asnjë gjurmë. Të arrestuar për dy grabitjet janë Fatian Xhyliu, Diñjon Memlika, Neim Avdulaj, Ernest Kupa, Dash Kupa, Aleksandër Murataj, Dritan Sinanaj, si dhe i penduari i bandës Admir Çerçepja.

e imunitetit të deputetit Saimir Tahiri, ish-ministër i Brendshëm, si dhe autorizimin për "arrestimin, heqjen e lirisë dhe kontrollin personal e të banesës". Ndaj tij u ngritën akuzat "Trafikim i lëndëve narkotike" e kryer në bashkëpunim me formën e grupit të strukturuar krim-

inal dhe "Korrupsion pasiv i funksionarëve të lartë të shtetit", i dyshuar si i implikuar në trafikun e drogës. Ish-ministri i Brendshëm përmendje në përgjimet e Habilajve, por Kuvendi nuk e dha autorizimin për arrestimin e tij, përveç kontrollit në banesë.



Gjatë ditës së djeshme drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Haki Çako, zhvilloi një vizitë zyrtare në Athinë, Greqi, ku u prit nga homologu i tij grek Konstantinos Tsouvalas. Qëllimi i kësaj vizite ishte forcimi i bashkëpunimit dypalësh në çështjet e rendit dhe sigurisë, si dhe nxitja e bashkëpunimit kundër krimit ndërkufitar, ku u ra dakord për organizimin e operacioneve të përbashkëta. Gjatë takimit u konfirmua bashkëpunimi i mirë ndërmjet autoriteteve policore të të dy vendeve dhe u evidentua përparimi konstruktiv që është arritur gjatë viteve të fundit, përmes takimeve të rregullta për luftën kundër krimit të organizuar dhe atij ndërkufitar.

Rëndësi e veçantë iu kushtua trajtimit dhe luftës kundër trafikimit të lëndëve narkotike. Drejtori Çako informoi homo-

Operacioni "Forca e ligjit", marrëveshje mes dy vendeve

Çako takon homologun e tij grek, bashkëpunim kundër krimit ndërkufitar



Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Haki Çako, me homologun grek Konstantinos Tsouvalas

logun grek në lidhje me planin e veprimit të qeverisë shqiptare "Forca e Ligjit", i cili fokusohet në luftën pa kompromis kundër krimit të organizuar dhe goditjen e grupeve kriminale, që trafikojnë lëndë narkotike. Mbi këtë çështje u ra dakord që mes dy palëve të ketë një bashkëpunim edhe më të thek-

suar në vijimësi. Drejtorët e Përgjithshëm ranë dakord, gjithashtu, për të ndjekur me prioritet format e ndryshme të krimit ndërkufitar. Për këtë qëllim, policitë e të dy vendeve do të organizojnë operacione të koordinuara, duke kryer patrullime të përbashkëta në zonat e vijës kufitare të dy vendeve; duke

përcaktuar pika të kontaktit për shkëmbim të menjëhershëm të informacionit mbi krimin e organizuar dhe ndërkufitar si dhe duke realizuar takime në nivel ekspertësh (teknikë) të të dy Policive të Shtetit për trajtimin e akteve kriminale në zonat afër pikave kufitare tokësore. Gjatë kësaj vizite, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Z.Çako u prit në një takim edhe nga ministri i Rendit Publik dhe Mbrojtjes së Qytetarit Z. Nikoloas Toskas, i cili konfirmoi edhe nga ana e tij bashkëpunimin shumë të mirë që ekziston midis dy policive si dhe ofroi mbështetjen e tij për thellimin e këtij bashkëpunimi.

Artan Habilaj shkoi në Greqi me mjetin e tij "AUDI" dhe u kthye me traget

Sistemi TMS, Tahiri dhe Gjebrea në "Audi" e Habilajve

U kthyen nga Greqia, nëpërmjet pikës kufitare të Qafë Botës

Ish-zv. ministrja e Brendshme, Elona Gjebrea udhëtoi në makinën tip "AUDI" me targa AA 003 GB, këto të dhëna janë zbuluar nga sistemi "TMS". Mësohet se udhëtimi ka qenë i përbashkët me ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri, i cili e merrte makinën nga kushërinjtë e tij, Habilaj. Në atë kohë, Artan Habilaj e të tjerë kanë qenë nën hetim nga Antimafia italiane për trafik lëndësh narkotike. Saimir Tahiri dhe Elona Gjebrea kanë dalë bashkërisht për në Greqi, në datën 08 gusht të vitit 2014. Ata kanë dalë nga Shqipëria me traget, nëpërmjet portit të Sarandës, pa makinë. Saimir Tahiri dhe Elona Gjebrea janë kthyer nga Greqia në datën 16 gusht të vitit 2014. Por në kthim, kanë hyrë me automjetin AA 003 GB, nga pika e kalimit kufitar të Qafë Botës, në Sarandë. Pra, daljen e kanë pa makinë dhe hyrjen e kanë me "AUDI"-n me targa AA003 GB. Lapsi.al raporton ecurinë e lëvizjeve të tyre në ato data sipas sistemit TMS, përkatësisht për datat 08.08.2014-16.08.2014. Konkretisht në datë 08.08.2014 në orën 09:33, Saimir Tahiri, ka dalë nga pika kufitare e portit Sarandë (Traget) për në Greqi. Gjithashtu, në datë 08.08.2014 në orën 09:32, Elona Gjebrea, rezultoi të ketë dalë nga pika kufitare e portit Sarandë (Traget) për në Greqi. Pra, Saimir Tahiri dhe Elona Gjebrea kanë dalë bashkërisht



DALJET NGA KUFIRI SHQIPTAR

Në datë 08.08.2014 në orën 09.33, Saimir Tahiri, ka dalë nga pika kufitare e Portit Sarandë (Traget) për në Greqi. Gjithashtu, në datë 08.08.2014 në orën 09.32, Elona Gjebrea, rezultoi të ketë dalë nga pika kufitare e portit Sarandë (traget) për në Greqi.

për në Greqi me traget (pa makinë). Ndërkohë, në datën 14 gusht të vitit 2014, Artan Habilaj ka dalë nga Shqipëria nga pika kufitare e Qafë Botës, në Sarandë për në Greqi, me automjetin AA 003 GB. Dalja është bërë në orën 10.51 minuta. Habilaj është kthyer dy ditë më pas në datën 16 gusht nga pika kufitare e Sarandës për në Shqipëri, me traget, pa makinë. Pra, Artan Habilaj shkoi në Greqi me mjetin e tij "AUDI" dhe u

kthye me traget. Mjetin e përdori Saimir Tahiri dhe Elona Gjebrea që hynë në Shqipëri nga Greqia, nëpërmjet pikës kufitare të Qafë Botës, me automjetin AA 003 GB. Konkretisht Saimir Tahiri ka hyrë në orën 13:31 në datën 16.08.2014 ndërsa Elona Gjebrea në orën 13:34 në datën 16.08.2014. Eshtë e qartë se Artan Habilaj është takuar me Saimir Tahirin në Greqi dhe i ka lënë automjetin me të cilin ministri i

HYRJET NË KUFIRIN SHQIPTAR

Saimir Tahiri dhe Elona Gjebrea që hynë në Shqipëri nga Greqia, nëpërmjet pikës kufitare të Qafë Botës, me automjetin AA 003 GB. Konkretisht Saimir Tahiri ka hyrë në orën 13:31 në datën 16.08.2014 ndërsa Elona Gjebrea në orën 13:34 në datën 16.08.2014.



25-vjeçari akuzohet për fshehje të të ardhurave

Biznesmeni Orest Sota ankimon masën e sigurisë

Biznesmeni Orest Sota ka depozituar ankimin për masën e sigurisë pranë gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda. Pak ditë më parë, gjykata caktoi masën "Arrest me burg" për Sotën. 25-vjeçari Sota, i cili u arrestua në fshatin Balldre të Elbasanit, pasi nuk i kishte ndaluar policisë, akuzohet për tre vepra penale: "Drejtimi i automjeteve në gjendje të dehur apo pa dëshmi"; "Mosbindja ndaj urdhrave të punonjësit të Policisë së Rendit Publik" dhe "Fshehja e të ardhurave". Policia e Elbasanit e arrestoi biznesmenin pasi ky i fundit nuk iu përgjigj thirrjes së policisë për të ndaluar. Nga kontrolli në makinën që e drejtonte pa patentë iu gjetën dhe iu bllokuan 863 mijë euro dhe tri patentat, dy për mjete lundruese në emër të Saimir Tahirit dhe një tjetër e gruas së ish-ministrit, Fatlinda Berisha. Ndërkohë, Prokuroria e Krimeve të Rënda është duke bërë hetim pasuror ndaj Sotës. Në gjyq, gjatë diskutimit të masës, prokurorët e Krimeve të Rënda, Elisabeta Imeraj dhe Gent Osmani, deklaruan se ka dyshime që paratë e gjetura në makinën e Sotës i përkasin ish-ministrit Tahiri.

KRIMINALITETI AKUZAT

Shkarkimi i Lallës dhe Zgurit, opozita skenar për të parandaluar mazhorancën

"Habilaj", Basha: Rama e Xhafaj dekonspiruan operacionin e arrestimit

"Së shpejti denoncojmë skandalin tjetër"

Valentina Madani

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, paralajmëroi dje se një tjetër denoncim që ka lidhje me "skandalet e kësaj qeverie" do të bëhet publik shumë shpejt, i cili është marrë nga burimet e partnerëve. Z.Basha takoi dje në ambientet e kryesinë së Kuvendit anëtarët e PD-së në Komisionin e Sigurisë për të vendosur për hapat që do të ndërmerren opozita kundër krimin dhe lidhjeve të tij me pushtetin. Z.Basha iu përgjigj akuzave të PS-së për përdorim sipas tyre nga Basha dhe PD të parave të pista për lobim me kompaninë 'offshore' amerikane, duke e cilësuar shashkë të bazuar në trillime. Basha paralajmëroi publikimin e një tjetri skandali qeveritar, për të cilin tha se është vënë në dijeni nga partnerët ndërkombëtarë dhe që po shqyrtohet nga ekspertët e selisë blu. Basha bëri të qartë se lufta kundër kriminit të organizuar dhe dekriminalizimit të qeverisë është emergjencë dhe për kreun e PD-së, largimi i Edi Ramës është hapi i parë. "Një shashkë e bazuar në mashtime, që s'mund të largojë vëmendjen nga skandalet e jashtëzakonshme të kësaj qeverie, as nga një skandal i madh që është vënë në dijeni të opozitës nga burime të partnerëve dhe po studiohet nga ekspertët tanë të sigurisë dhe të ligjeve. Këto fakte dhe të tjera të sjella në vëmendjen e opozitës do t'i bëhen të njohura publikut", deklaroi Z.Basha, i cili pak më parë denoncoi i pari përmendjen e Vangjush Dakos në përgjimet e EULEX-it. Z.Basha akuzoi ministrin e Brendshëm, Fatmir Xhafaj se me urdhër të kryeministrit Edi Rama ka dekonspiruar operacionin për arrestimin e tre ish-zyrtarëve të lartë të policisë. "Dekonspirimi i operacionit për arrestimin e 3 zyrtarëve të policisë u bë nga Xhafaj me porosi të Ramës për të mbrojtur Tahirin. Policia e Shtetit dhe Ministria e Brendshme kanë funksionuar si organizatë kriminale. Vetingu duhet të nisë me Ministrinë e Brendshme dhe qeverinë. Hapi i parë është largimi i Ramës nga kreu i qeverisë", u shpreh Z.Basha.

Kreu i opozitës i kërkoi prokurorisë të arrestojë Saimir Tahirin dhe të thellojë hetimet për zyrtarët e policisë të lidhur me krimin. "Prokuroria të hetojë kokat e policisë dhe të arrestojë Tahirin. Rama bëri gjithçka për të ndaluar arrestimin e Tahirin dhe shefat e policisë së korruptuar. Opozita parashtron

si domosdoshmëri largimin e Ramës. Emergjencë absolute, pastrimi i qeverisë nga krimi dhe kjo nis me largimin e Ramës", tha Basha. Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, foli edhe për çështjen e kryeprokurorit të ri, teksa akuzoi se mazhoranca nuk ka asnjë mundësi kushtetuese që të shkarkojë kre-

un e KQZ-së, Klement Zgurin dhe paralajmëron se nëse e bën, do të marrë përgjigjen e duhur nga opozita. "Nuk ka mundësi kushtetuese që kreu i KQZ të shkarkohet nga kjo mazhorancë. Çdo hap do të marrë përgjigjen e merituar", deklaroi kreu i PD-së. Edhe sa i takon kryeprokurorit, Basha këmbëngul se nuk mund ta emërojë Edi Rama. "Prokurorin nuk mund ta emërojë as Edi Rama, as Saimir Tahiri dhe as Vangjush Dako. Kemi plan të plotë veprimi për të parandaluar në mënyrë ligjore dhe për t'u përgjigjur çdo veprimi anti-kushtetues", -tha Basha.



Kreu i PD-së Lulzim Basha

HETIMI

Prokuroria ka nisur verifikimet për kontratën e PD me një kompani amerikane të lobimit. Kontrata mes PD dhe "Stonington Strategies" kapte vlerën e 25 mijë USD në muaj. Afati i kontratës ishte tremujor dhe qëllimi ishte "projektimi dhe implementimi" i fushatës së PD.

Zgjedhja, Mustafaj: Kryeprokurori, i përkohshëm e me konsensus

Ish-ministri i PD-së, Besnik Mustafaj, deklaroi dje se Prokuroria i Përgjithshëm që duhet të zgjedhet i përkohshëm në këtë detyrë, duhet të ketë mbështetjen e të gjitha palëve politike. Mustafaj theksoi në "News 24", se mazhoranca duhet të tregojë këmbëngulje dhe angazhim për të vijuar çështjet që janë në proces. "Në këtë tension që ka krejt opinionin publik, përtej skandaleve të denoncuar, por tashmë të faktuara, që lidhen me implikimin e zyrtarëve të lartë të policisë dhe politikës me elementë kriminalë, zgjedhja e një kryeprokurori të përkohshëm bëhet edhe më e vështirë. Është një çështje e ndërlikuar, delikate, pasi kërkohet që ky prokuror që vjen me vetëdijen se është i përkohshëm, duhet të ketë mbështetjen e të gjitha palëve. Ky prokuror i tranzicionit, duhet të ketë mbështetjen të gjerë që të vazhdojë këtë punë të nisur, por edhe të tjerat që ne nuk i dimë, me të njëjtën këmbëngulje dhe angazhim të madh. Opozita nuk ka një mekanizëm të tillë që të jetë faktor në zgjedhjen e këtij prokurori. Por nëse mazhoranca nuk e ka këtë vullnet për të përfshirë të gjitha palët në këtë proces, atëherë do të ketë qëndrime të tjera", u shpreh Besnik Mustafaj.



Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim Monika Kryemadhi, dje në emisionin "Studio e Hapur" me Eni Vasilin në "News24"

LOBIMI

Deputetja e PS-së, Blerina Gjylameti, i kërkoi dje Z.Basha që të japë llogari për 1 milion dollarët të lobuar në SHBA. Ndërkohë që kreu i PD-së u përgjigj: "Një shashkë e bazuar në mashtime, që s'mund të largojë vëmendjen nga skandalet e jashtëzakonshme të kësaj qeverie."

BERISHA



"Balili ka videot e orgjive të Ramës dhe 3 ministrave"

Ish-kryeministri Sali Berisha, pas sekuestros së vendosur ndaj hotelit luksoz të Balilajve, deklaroi se Balili ka videot e orgjive të Noriegës dhe tre ministrave të tij në "Santa Quaranta". "Balili ka videot e orgjive të Noriegës dhe tre ministrave të tij në 'Santa Quaranta'! Qytetari dixhitali pyet: Përhëndetja doktor. Dyshekët dhe batanijet e pjatit në 'Santa Quaranta' u sekuestruan. Po videot e orgjive të Ramës dhe tre ministrave të tij, Ahmetit, Gjikuirit dhe Tahirin kush i ka? Ato i ka Balili si mburojë dhe hajmali për arrestimin e tij!", thuhet në mesazhin dërguar ish-kryeministrit Sali Berisha.



Shkarkimi i Zgurit, Arben Ristani: Mazhoranca, metoda antiligjore

Ish-kryetari i KQZ-së, Arben Ristani, shprehet se ligjërisht PS-ja nuk mund ta shkarkojë Klement Zgurin nga kryesimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ristani del në krah të Zgurit, ndërsa akuzon Partinë Socialiste për vendimin e saj. "Mundet sepse lidhshipi i PS, apo Rama, nuk ka asgjë të pamundur, është një njeri që nuk ka të bëjë me ligjet dhe rregullat e këtij vendi. Kështu që për njerëz të tillë, për një gjendje natyrore në pyll, gjithçka mund të ndodhë", tha Ristani. Për të treguar paligjshmërinë e shkarkimit, Ristani citon Kodin Zgjedhor, që parashikon rastet e largimit të parakohshëm të mandatit të kryetarit të KQZ. "Kodi Zgjedhor përcakton që është KQZ që shikon dhe monitoron edhe punën e kryetarit të tij dhe në rast se konstatohen shkelje, është po KQZ ajo që i drejtohet parlamentit për të nisur procedurën të tillë, nuk janë partitë politike. Nga ana ligjore është pamundur", deklaroi Ristani për "Report TV". Si sekretar i përgjithshëm i PD-së, Ristani sqaroi edhe qëndrimin e demokratëve për të ndaluar shkarkimin. "PD nuk ka rrugë të tjera përveç atyre ligjore dhe përveç faktit që është zëdhënës edhe e interesit publik në këto raste, për t'i bërë të ditur publikut dhe ndërkombëtarëve që në Shqipëri nuk zbatohet ligji dhe Kushtetuta", u shpreh Ristani. Por a ndikon sjella politike në punën normale të KQZ? "Të gjitha sjelljet antiligjore ndikojnë në të gjitha institucionet, jo vetëm në KQZ. KQZ është një institucion si të gjitha institucionet e këtij vendi, që ka nevojë të shohë partneritet pro ligjit në të gjithë vendin", tha Ristani.

Intervista në "Studio e Hapur", kryetarja e LSI: Edi Rama po bllokoi KLP

Kryemadhi: Dekonspirimi i operacionit nisi me diskutimin e çështjes "Tahiri" në Kuvend

"Bashkëpunimi me PS? Nuk jemi ushtarë as të PS-së, as të PD-së"

Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi komenton situatën politike në vend, pas zhvillimeve të ditëve të fundit, ku Prokuroria e Krimeve të Rënda ka lëshuar urdhër-arreste për disa ish-zyrtarë të lartë të policisë. Në emisionin "Studio e Hapur" me Eni Vasilin në "News24", Kryemadhi ka folur për dekonspirimin e urdhrave të policisë ndaj ish-zyrtarëve, të cilët dyshohet se janë të implikuar në trafikun e drogës së bandës së Habilajve. "Mendoj se që në momentin që filloi të diskutohet çështja "Tahiri" në parlament, janë larguar të gjithë. Tashmë shtrohet pyetja sa ka qenë e implikuar policia, që i ka lejuar këta ish-zyrtarë të largohen nga vendi. Varet tani si do jetë bashkëpunimi i policisë me prokurorinë", u shpreh ajo.



Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim Monika Kryemadhi

Dekonspirimi fillon që në momentin që nuk u dha e drejta prokurorisë në komisionin e verifikimit të mandateve që në parlament, gjë që ishte absurde. E dyta më pas vjen mënyra sesi është proceduar, unë nuk jam juriste, por në aspektin politik, bërjen e një analize të tillë, tregon që është shumë e thjeshtë, sepse personat, të cilët janë përfshirë janë personat që kanë bërë veprat penale dhe e dinë më mirë. Se nuk ka marrë Saimir Tahiri shportat me kanabis dhe i ka çuar në Itali. Kanë qenë grupet kriminale që i kanë bërë, por ka qenë policia ajo që, po themi, ka pastruar territorin, ka krijuar zonë të pastër që të lëvizin në mënyrë të lirshme grupet kriminale dhe normal që kush ka qenë drejtor i policisë në Vlorë, Gjirokastrë etj.

Ne po dëgjojmë për tre apo katër veta, të cilët janë arratisur, por sa të tjerë mund të ketë të përfshirë, të cilët janë të larguar dhe nuk janë.

Pra, ju thoni që praktikisht e kanë ditur...

Unë mendoj që në momentin që filloi të diskutohet çështja Tahiri në parlament, të gjithë janë larguar. Problemi qëndron sa ka qenë bashkëpunimi me drejtoritë e policisë për të mos lejuar personat e implikuar për t'u larguar nga Shqipëria ose sa ka qenë e implikuar tashmë policia që i ka lejuar këta drejtues të policisë të largohen nga Shqipëria. Nuk di ç'është them se nuk e di deri ku shkon bashkëpunimi i prokurorisë me policinë, ndërsa policia mund të ketë çuar njoftime që këta persona mos të dalin jashtë Sh-

qipërisë dhe ata kanë dalë pasi prokuroria ka çuar njoftimin, por unë jam kohezion që absolutisht personat janë njoftuar. Ne e kemi shumë të qartë rastin e Xibrakës, i cili njoftoi Genc Xhixhën për t'u larguar.

Mendoni që nuk do bëhen më të gjallë këta persona?

Problemi është sa policia do të jetë e aftë për të lëshuar një urdhër arresti në vendet ku ata janë, sepse ata dihen shumë mirë ku janë, i di dhe policia, i di dhe prokuroria.

Ju e dini ku janë?

Unë kam përshtypjen se këtej vërdallë do jenë në rrethinat e Shqipërisë, rreth kufirit të Shqipërisë. Nuk e kam idenë tërësisht, por afër janë dhe, nëse policia shqiptare për t'i ndaluar dhe për t'i arrestuar, jam e bindur që e bëjnë, sepse ka bashkëpunim gofite me Greqinë, gofite me Turqinë apo dhe me Italinë. Edhe me Australinë mund ta realizojnë, po të duan.

Basha thotë se nuk lejojmë që Rama të zgjedhë prokurorin e ri. Si do pengohet ky proces, apo është thjesht një deklaratë politike?

Ne kemi komunikuar shpesh këto kohë e fundit me z. Basha për të ndjekur të gjitha hapat që duhen njëri pas tjetrit. Sigurisht që jemi në komunikim edhe me ekspertë ligjorë, duke pasur parasysh edhe situatën në të cilën ndodhemi. Ka disa variante. Ajo që është më problematike me Kushtetutën e

re, të miratuar me rregullat e reja më 22 korrik të 2016-ës, thuhet që mandatin e prokurorit të përgjithshëm e deklaroi të mbyllur Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe përdorisë në nuk e kemi, kush e deklaroi këtë? Varianti tjetër është që mund të presim një shpjegim nga Gjykata Kushtetuese ose mund të shkojmë drejt Komisionit të Venecias për të diskutuar e për të marrë një shpjegim tjetër. Një variant tjetër është bllokimi i parlamentit, nxjerrja e njerëzve në rrugë etj.

Me gjithë këto variante nuk e pengoni dot nëse mazhoranca dëshiron ta bëjë. Ajo i ka votat dhe mund ta bëjë.

Edi Rama tani nuk mund të bëjë çdo gjë. Ai është një njeri që nuk është normal nga trutë e kokës.

Flasim pak për Bashkinë e Tiranës. Në mbledhjen e djeshme të Këshillit Bashkiak ju nuk keni dhënë votat dhe Velaj ka shkarkuar 4 administratorët që vinin nga radhët e LSI-së. Cili është qëndrimi juaj?

Qëndrimi im është shumë i thjeshtë. LSI-ja nuk i dha votat vetëm për palmat. Shqiptarët duhet të kujtojnë që palmat e rrugës Tiranë-Durrës nuk janë pronë e Bashkisë së Tiranës, por e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Dhe 2.5 milionë euro për palmat që janë mbjellë, nuk i ka paguar as Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, por Fondi i Zhvillimit Shqiptar. Dhe kjo është e paligjshme dhe Drejtoria e Përgjithshme të Rrugëve në atë kohë nuk e ka pranuar. Dhe sot nëpërmjet një buxheti prej 60 milionë lekë të vjetër, që gjoja do të mbjellin pisha në vend të palmave, kërkohet të mbulohet kjo. Ky kryeministër është arrogant dhe një njeri duhet të zbatojë ligjet e shtetit.

Do të bashkëpunoni me kryetarin e Bashkisë apo jo?

Unë e kam thënë që bashkëpunoj edhe me Edi Ramën në momentin që sjell statusin e minoritetit të 19 votat e LSI-së i ka. Do të sjellë bashkia projekte për rrugë? I ka votat. Por jo të më marrë për buallë. Ne nuk jemi ushtarë as të PS-së dhe as të PD-së. Ne jemi Lëvizja Socialiste për Integrim, kam votat e mia. I kam marrë e vetme frazë përballë një presioni të jashtëzakonshëm, përballë me bandat, përballë me imoralitetin politik. Nuk kemi marrë pak, kemi marrë 225 mijë e 73 vota.



MARRËVESHJA
"Do ta përmendja zhgënjimin e 1 majit, darka e Metës me Ramën. Po të isha prezent nuk do ishte kjo situatë që është sot. Edhe sa i përket marrëveshjes PS-LSI nuk kam qenë absolutisht e përfshirë", deklaroi dhe, Kryemadhi.



ILIR META
"Ilir Meta është shtetar shumë i mirë. Sigurisht është edhe lider shumë i mirë. Por është për vendet skandinave, jo për këto vendet ku krimi është ulur këmbëkryq. Ai është tolerant, dhe ka besim. I beson njerëzit", tha kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi.



Situata aktuale politike është mjaft e nxehtë. Opozita, gjithashtu, ka reaguar ndaj ngjarjeve të fundit, është fokusuar çështja të dosja "Habilaj", çështja Sota çështja Tahiri. Ka pasur akuza dhe kundër akuza, si e shikoni këtë situatë?

Për shqiptarët është një situatë e vështirë gofite ekonomike, gofite politike, ndërsa për klasën politike do ta quaja një korbë të ngatëruar, që si i miri dhe i keqi bëhen pis, dhe pavarësisht nga kjo, do të mbajnë të gjithë përgjegjësi bashkë. Për arsyen, sepse gjendimi përballë një fakti të kryer, përballë një fakti që vjen si rezultat i partnerëve ndërkombëtarë, nuk vjen si rezultat as si i prokurorisë shqiptare dhe as i politikës shqiptare, as si rezultat i institucioneve shqiptare, por si rezultat i institucioneve ndërkombëtare, të cilëve u ka ardhur në majë të hundës për mënyrën se si qeverisët Shqipëria dhe për mënyrën se si Shqipëria po bën politikë. Dhe vjen një moment që ata nuk durojnë më dhe shpërthejnë, i ofrojnë klasës politike një situatë të tillë në tryezën tonë, e cila është shumë e rëndë. Tregon se si jeta politike shqiptare është e kapur dhe tregon se si jemi të gjithë me këmbë dhe duar të lidhur, sepse nëse duam të reagojmë, do ta kemi shumë të vështirë për të reaguar.

Për personat që janë aktualisht në kërkim, domethënë janë arratisur, kush e ka dekonspiruar sipas jush, sipas informacioneve, nëse keni të tilla?

EPSA SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:

- 1- Apartament** me sip. 147 m², ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8270, Numri Pasurise 3/40+1-16., Volum.42, Faqe.56. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **148.176 Euro.**
- 2- Garazhd, Nr.1** me sip. 520 m², Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane, ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-G1, vol.18, faqe.72. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **445.536 Euro.**
- 3- Njesi** me sip. 50 m², ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-N2, vol.18, faqe.76. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha.Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **120.960 Euro.**
- 4- Garazh N.2** me sip. 50 m², Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane, ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-G2, vol.18, faqe.73. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha.Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **42.840 Euro**
- 5- Garazh N.3** me sip. 570 m², Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane, ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-G3, vol.18, faqe.74. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **488.376 Euro.**
- 6- Apartament** me sip. 402.9 m², Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane, ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241+1-1, Volum.18, Faqe.78. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **731.022 Euro.**
- 7- Njesi** me sip. 310 m², Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane, ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-N1, vol.18, faqe.75. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **750.920 Euro.**
- 8- Njesi** me sip. 364.7 m², Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane, ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-N3, vol.18, faqe.77. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **827.139 Euro.**

Ankandi per te gjitha pasuritë e sipërcituaru do te zhvillohet datë 05.12.2017 ora 16.00 në zyrat e shoqerise EPSA shpk te ndodhura ne adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratari", K.6, Tirane.

Alex Soros: E mrekullueshme të takoja kryeministrin vizionar

Djali i George Soros vjen në Tiranë, takohet me Edi Ramën

Në shtator kreu i qeverisë takoi në SHBA manjatin hungarez.

Alex Soros, djali i manjatis hungarez-amerikan, George Soros prej dy ditësh po zhvillon një vizitë në Shqipëri. Gjatë qëndrimit në Tiranë ai ka vizituar disa prej zonave më të frekuentuara nga turistët, por nuk ka lënë jashtë vëmendjes edhe përfaqësues të politikës. Këtë të premtë ai ka publikuar në llogarinë e tij në "Instagram" foto nga takimi me kryeministrin vizionar Edi Rama, të cilin ai e cilëson si kryeministër vizionar, artist bashkëkohor dhe shkrihtar. "Ishte e mrekullueshme të takoja kryeministrin vizionar Edi Rama në Tiranë, në zyrën e tij unike, më e veçanta e një kryeministri. Çfarë duhet të presim më pak nga një artist bashkëkohor, shkrihtar dhe ish-lojtar profesionist në basketboll!", shkruan Alex Soros. Ky është takimi i dytë i Alex Soros me kryeministrin Edi Rama pas atij në Nju Jork në muajin shtator të këtij viti, ku kreu i qeverisë u prit nga George Soros dhe pasardhësi i tij, Alex. Në shtator Rama takoi jashtë axhendës zyrtare, privatisht George Soros, i cili është lakuar kaq shumë nga politika shqiptare si një nga kundërshtarët e presidentit aktual Donald Trump. Edhe këtë takim të shtatorit e bëri me dije djali i manjatis hungarez Alex Soros, duke publikuar foto në rrjetin social me kryeministrin shqiptar Edi Rama dhe babanë e tij. "Gjithmonë është një kënaqësi të takosh kryeministrin shqiptar Edi Rama.



Kryeministri Edi Rama me Alex Soros

Një rilindës, i cili është bërë simbol i demokracisë liberale në Shqipëri dhe, gjithashtu, një artist i njohur botërisht. Për të mos përmendur që është i vetmi kryeministër që mban veshur T-shirt të Michael Jordan në takimet zyrtare, edhe pse jam një fans i përjetshëm i Knicks, nuk kam asgjë personale, përveç respektit", shkroi në këtë kohë djali i Soros. Ndërkohë në Shqipëri kryeministri Rama ka marrë kritika të shumta nga opozita për raportin që ai ka me George Soros. Madje këto kritika u shtuan në kohën, kur Rama kritikoi presidentin aktual Donald Trump në kohën kur ai ishte kandidat për president i SHBA-së. Soros është i njohur për mbështetjen e kandidatëve të majtë në shumë vende të botës, përfshi edhe Shtetet e Bashkuara, ku në fushatën e fun-

dit, mbështeti hapur Hillari Klintonin. Soros është mik kryeministrin Edi Rama. Madje shefi i qeverisë shqiptare ishte i fuar edhe në dasmën e tretë të multimilardierit para tre vitesh. Ndërkohë që Soros ka qenë edhe dy herë në Tiranë. Vizitën e parë bëri në vitin 2005, ku Soros erdhi në Tiranë në një mision të veçantë: Nxjtitjen e qeverisë shqiptare në zbatimin e programit për integrimin ekonomik-social të romëve si dhe prezantimit strukturën e re të Fondacionit Soros në Shqipëri. Gjatë vizitës së tij të parë në Shqipëri, Soros u takua me kryeministrin e asaj kohe, Sali Berisha dhe kryetarin e bashkisë së Tiranës në atë kohë, Edi Rama. Ndërkohë gjatë vizitës së tij të parë në Shqipëri, Bashkia e Tiranës i dha Sorosit titullin "Qytetar Nderi".

Ngjela: Rama të ikë, ndryshe do të përfundojë keq

A vokati i njohur, Spar tak Ngjela deklaroi dje, se kryeministri Edi Rama do të përfundojë shumë keq nëse nuk jep dorëheqjen. Në një koment të tij, Ngjela analizo situatën që ndodhet qeveria dhe vendi. "Gjendja ekonomike është në rënim; dhe nga qeveria paraqiten përqindje të rritura zhvillimi si kongreset e tiranisë Hoxha. Vetëm borxhe dhe gjobitje drastike se shteti është pa para, por njerëzit e papunë duhet të hanë bukë me përqindjet e Ramës. Pa prodhim dhe pa asnjë skemë investimi, se qeveria është e izoluar ngaqë po bllokon reformën në drejtësi", shprehet Ngjela. "Në fakt, ky kryeministër tani ka ikur, por ligësia nuk e lejon ta mendojë, dhe i jep një shpresë se mendon edhe Saliun si ndihmë", tha Ngjela. "Edi Rama nuk jep dorëheqjen si kryeministër. Po kush është ky? Fakti që nuk jep dorëheqjen është një nga ata që po ikin që tani nga sytë këmbët. Nëse nuk jep dorëheqjen, provon se ka plane ogurzeza në mendje. Por, do të përfundojë shumë keq", u shpreh Ngjela.



Olta Xhaçka: Shqipëria mbështet Kosovën për anëtarësimin në NATO

Shqipëria do të mbështesë Kosovën në proceset e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, përfshirë edhe NATO-n", deklaroi dje, në Prishtinë ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka. Gjatë një takimi me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, Xhaçka theksoi se "Shqipëria do të jetë mbështetëse e fuqishme për Republikën e Kosovës, për forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të saj". Xhaçka, vlerësoi dinamiken e re qeverisë të kryeministrit Haradinaj, thuhet në njoftimin për shtyp të qeverisë kosovare. Haradinaj dhe Xhaçka biseduan për zhvillimet aktuale politike dhe bashkëpunimin bilateral ndërmjet të dyja shteteve, me fokus të veçantë mbrojtjen dhe sigurinë. Kryeministri vlerësoi kontributin e Shqipërisë në sigurinë rajonale dhe globale si anëtare e NATO-s, që ka ndikim edhe për sigurinë e Kosovës. "Kosova mbështet të përvojat shqiptare në procesin e anëtarësimit në këtë institucion shumë të rëndësishëm të sigurisë globale", nënvizoi Haradinaj. Haradinaj theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me Kosovës dhe Shqipërisë si dhe mundësinë e thellimit të mëtjetshëm në të gjitha fushat e interesit të përbashkët. Gjatë takimit u bisedua edhe për mbledhjen e përbashkët të dy qeverive, e cila do të mbahet më 27 nëntor në Korçë, për arritjen e marrëveshjeve konkrete dhe zbatimin e tyre, me qëllim thellimin e marrëdhënieve bilaterale. Ministria e Mbrojtjes u prit edhe nga Presidenti Hashim Thaçi. Kosova po mëson nga përvoja 105 vjeçare e Shqipërisë, ka deklaruar në takim, Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Presidenti Thaçi ka theksuar se Kosova ka mbështetjen e Shqipërisë në botë dhe se anëtarësimi i rajonit në Aleancën Veri-Atlantike është vetë siguria e rajonit. Nëpërmjet një postimi në statusin e tij social "Facebook", Presidenti i Kosovës Thaçi në vijim shprehet se "Ne kemi mbështetjen e saj kudo në botë. Ndamë bindjen e njëjtte me ministrin e Mbrojtjes së Shqipërisë, se anëtarësimi i shteteve të rajonit në Aleancën Veri-Atlantike do të jpeft fund të gjitha problemeve të sigurisë në rajonin tonë.

"Kosova mbështet të përvojat shqiptare në procesin e anëtarësimit në këtë institucion shumë të rëndësishëm të sigurisë globale"

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes të ashenzorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,046,800 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktëshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes të ashenzorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 19 Dhjetor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve UPS të dhomave të serverave të Bankës së Shqipërisë".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 2,700,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktëshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve UPS të dhomave të serverave të Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 18 Dhjetor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

VENDIMI I GJYKATËS/ Policia: Vendosëm nën sekuestro preventive edhe 36 apartamente e 28,690 m2 truall

Sarandë, sekuestrohet resorti luksoz "Santa Quaranta"

Në hotelin e Balilit u gjetën familjarët, punonjësit kishin marrë "pushim"

Arbër Sulo

SARANDË

Kompleksi luksoz "Santa Quaranta" në Sarandë nuk do të jetë në duart e familjes së Klement Balilit, por do të administrohet dhe përdoret nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Pas vendimit të dhënë nga Gjykata e Krimeve të Rënda, policia ka sekuestruar pasuritë e 45-vjeçarit Klement Balili, i cili akuzohet për trafik ndërkombëtar droge dhe njihet ndryshe si "Eskobari i Ballanit". Me vendimin e gjykatës në duar, dhjetëra forca policie dhe përfaqësues të Prokurorisë zbarkuan dje në qytetin bregdetar dhe vunë nën sekuestro preventive resortin turistik të Balilit, si dhe prona të tjera të familjes së tij. Mësohet se në hotelin e famshëm dhe të përfolur se në të kanë fjetur edhe ministra të kabinetit "Rama" me dashnore, kanë qenë vetëm familjarë të Klement Balilit, të cilët janë dhe pronarë të biznesit. Burime për "Gazeta Shqiptare" bënë me dije se gjatë kontrollit në hotel nuk u gjet asgjë e jashtëligjshme, ndërsa punonjësit ishin njoftuar që më parë që ditën e djeshme të mos shkonin në punë. Ndërkohë, pas ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, policia deklaroi zyrtarisht se ka sekuestruar ish-kampin e Pushimit të Punëtorëve në Sarandë (aktualisht hotel "Santa Quaranta"), 28,690 m2 truall dhe 36 apartamente e njësi shërbimi, me rreth 2.178 m2 sipërfaqe.



I kerkuari, Klement Balili



Hoteli "Santa Quaranta" në Sarandë



Policia gjatë kontrollit në ambientet e resortit luksoz



PRONAT E VËNA NËN SEKUESTRO

- Ish-kampi i Pushimit të Punëtorëve në Sarandë, aktualisht hotel "Santa Quaranta"
- 28.690 m² truall
- 36 apartamente e njësi shërbimi, me rreth 2.178 m² sipërfaqe

KONTROLLI

Mësohet se në hotelin e famshëm dhe të përfolur se në të kanë fjetur edhe ministra të kabinetit "Rama" me dashnore, kanë qenë vetëm familjarë të Klement Balilit, të cilët janë dhe pronarë të biznesit. Burime për "Gazeta Shqiptare" bënë me dije se gjatë kontrollit në hotel nuk u gjet asgjë e jashtëligjshme, ndërsa punonjësit ishin njoftuar që më parë që ditën e djeshme të mos shkonin në punë.

se paralelisht me procedimin për trafik narkotikësh, Drejtoria për Hetimin e Krimit Ekonomik e Financiar në Departamentin për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimit e Rënda në Policinë e Shtetit, ka investiguar dhe përcjellë në vazhdimësi të dhëna mbi pasur-

Nga dyshekët te frigoriferët, ja si kaloi në "filtër" hoteli i Klement Balilit

SARANDË - Paraditen e djeshme, forca të shumta policore mësnyë në resortin luksoz të të shumëlëkuarit Klement Balili (ish-kreu i Transporteve në Sarandë). Në pamjet filmike të sigurua nga "News 24" dhe "GSH" vihen re punonjësit e policisë teksa hyjnë në hotelin e famshëm "Santa Quaranta", i cili u sekuestrua dje bashkë me prona të tjera të të ashtuquajturit "Es-



kobari i Ballanit". Në video duket qartë momenti kur blutët kontrollonin në qdo cep të dhomave, hapin dollapët, ngrënë dyshekët dhe fo-

tografojnë qdo cep të tyre. Kontrolli ishte aq i rreptë sa ka përfshirë edhe frigoriferin. Pavarësisht kontrollit të imtësishëm, në ambientet e kompleksit turistik nuk është gjetur ndonjë gjë kompromentuese. Ndërkaq, familjarët e 45-vjeçarit të shpallur në kërkim nuk kanë reaguar. Mësohet se ata kishin urdhëruar punonjësit që gjatë ditës së djeshme të mos shkonin në punë.

itë e anëtarëve të dyshuar të këtij grupi, të cilat dyshohet se janë vendosur nga aktiviteti kriminal. Mbi bazën e këtij materiali, Prokuroria për Krimet e Rënda ka regjistruar procedimin pasuror nr.5, të vitit 2017, për hetim pasuror për gjitha lidhjet familjare të grupit "Balili". Mbi bazën e këtij materiali policor, bazuar në ligjin nr.10192, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", (i njohur si ligji "Antimafia"), Prokuroria e Krimeve të Rënda i kërkoi Gjykatës së

Shkallës së Parë për Krimet e Rënda vendosjen nën sekuestro të aseteve. Policia e Shtetit ka ekzekutuar sot (dje) vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, të pasurive në emër të Kelmend dhe Bashkim Balilit, që janë: Ish-kampi i Pushimit të Punëtorëve në Sarandë, aktualisht hotel "Santa Quaranta"; 28,690 m2 truall; 36 apartamente e njësi shërbimi, me rreth 2.178 m2 sipërfaqe. Këto pasuri të sekuestruara do të administrohen dhe përdoren nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Grupi "Balili" është një nga grupet kryesore të skeduar nga Policia e Shtetit në kuadër të operacionit "Forca e Ligjit", që ka për objekt edhe goditjen e pasurive apo aseteve me burim kriminal. E në këtë kuadër, hetimet po vijojnë me intensitet. Policia e Shtetit fton këdo që disponon të dhëna apo informacione të vlefshme për identifikimin dhe zbulimin e pasurive apo aseteve të tjera në pronësi të personave të mësipërm apo lidhjeve të tyre të afërta, të telefonojnë në numrat falas 112 dhe 129, duke garantuar ruajtjen e anonimatit dhe goditjen e ashpër të elementëve antiligjore.

I SHUMËKËRKUARI

Burime nga prokuroria bëjnë me dije se Klement Balili pjesën më të madhe të pasurive e ka në emër të familjarëve të tij dhe shokëve dhe se këto pasuri shtrihen kryesisht në Sarandë, Delvinë dhe në Tiranë. 45-vjeçari është person në kërkim prej më shumë se një viti nga drejtësia shqiptare dhe ajo greke, pasi akuzohet për trafik ndërkombëtar të lëndëve narkotike.



Prangoset pas 8 muajsh pronari i magazinës me 12 tonë kanabis

PËRMET - Policia e Gjirokastrës ka vënë në pranga një 61-vjeçar, i cili ishte shpallur në kërkim për veprat penale "Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike"; "Organizatë kriminale" dhe "Kryerje e veprave nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal". Bëhet fjalë për shtetasin Ismail Saliu, banues në fshatin Pagri të Përmetit. Sipas bluve, ai ishte shpallur në kërkim që në prill të këtij viti, pasi në magazinën në pronësi të tij u gjet dhe u sekuestrua në cilësinë e provës materiale një sasi prej 12 tonë kanabis sativa. "Ndalimi i shtetasit të mësipërm u bë në zbatim të urdhrit të ndalimit të datës 25. 04. 2017 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, në bazë të vendimit nr.226, datë 24.04.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, e cila ka caktuar masën e sigurimit "Arrest në burg në mungesë", thuhet në njoftimin e policisë. Në aksionin e policisë në atë kohë u arrestuan dy nga administratorët e depove, përkatësisht Rustem Muçelli, 51 vjeç dhe Egerem Ali, 60 vjeç, banues në fshatin Pagri. Gjithashtu, në kuadër të operacionit "Pagri" u ndalua në prill edhe kryeplaku i fshatit, Koço Zaimaj, 58 vjeç, për moskallëzim krimi.

Policia shoqëron 6 persona si të dyshuar për ngjarjen në Dukagjin

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Pasditen e së enjtes kemi përjetuar ferrin. Tre persona të maskuar dhe të armatosur na dolën para në afërsi të antenave në K1r. Ata na urdhëruan të zbrisnim nga makina, me të cilën po udhëtonim. Na ulën në tokë dhe na thanë të dorëzonim celularët. Më pas na thanë ikni dhe mos e ktheni kokën. U detyruam që të ecim para, pasi ishim me automatikë në duar dhe kishim frikë se do të na vrisnin". Kështu tha dje, Nik Hasani, njëri prej pasagjerëve të fuoristradës "Land Rover" me targa AA285DG që ra pre e grabitjes në zonën e Dukagjinit në Shkodër. Një ditë pas ngjarjes, burime nga policia e qytetit verior pohuan se tre persona ende të paidentifikuar i kanë bërë me shenjë drejtuesit të mjetit ku udhëtonin 7 pasagjerë që të ndalonte. Mësohet se agresorët kanë qëlluar me armë mbi gomën e parë të makinës. Sipas bluve, autorët u kanë marrë telefonat pasagjerëve dhe i kanë lënë të largohen. Ndërsa, drejtuesit të fuoristradës i kanë marrë portofolin me para (rreth 1 milion lekë të vjetra). Gjithashtu, policia sqaroi se nuk është

Pasagjerët: Ja si na grabitën dhe terrorizuan 3 maskat me kallashë

"Na thanë mos e ktheni kokën pas se do ju vrasim"



Fuoristrada e djegur nga grabitësit



Pasagjeri
Marash Vogli



Nik Hasani duke
folur për "GSH"

ushtruar dhunë fizike, ndërsa automjeti u gjet i djegur. Në lidhje me këtë ngjarje të rëndë janë shoqëruar 6 persona, mes të cilëve dyshohet të jenë 3 autorët e grabitjes. Tre nga të shoqëruarit janë nga Shoshi i Dukagjinit dhe tre të tjerë nga Pulti. Ndërkaq, pasagjerët treguan me detaje për "GSH" terrorin që përjetuan në rrugë.

GRABITJA

Marash Vogli, Nik Hasani, Gjon Livadhi, David Larushku, Petrit Vogli dhe Lazer Martinaj po udhëtonin në makinën e Petrit Kërçit, kur rreth orës 14:00 të së enjtes u ndaluan nga 3 persona të armatosur. Pas grabitjes, për afro 50 min, pasagjerëve iu është dashur të ecin në këmbë derisa kanë

gjetur celular për të njoftuar policinë. Pasagjeri Nik Hasani pohoi se "Nuk arrita t'i njoh grabitësit, por kuptova se ishin nga zona e Dukagjinit. Unë po t'i njoh, edhe sikur djali im të jetë, them që më ka dalë djali përpara dhe më ka grabitur. Jemi ndërjeq, pasi Dukagjini nuk e ka në traditë këtë ndodhi. Ata nuk na dhuan, por vetëm

na morën telefonat. Mbjamend, se njëri prej tyre qëlloi me armë në tokë". Një prej grabitësve i ka shoqëruar për rreth 100 m, ndërsa ka qëlluar. Pasagjeri, Marash Vogli u shpreh se grabitësit i kërcënuan se do i vrisnin nëse kthenin kokën. Pasi janë larguar të gjithë, maskat i kanë vënë flakën makinës duke e djegur totalisht.

"Kemi qenë në makinë si pasagjerë, kur papritur na dolën 3 persona të maskuar me rroba të zeza dhe me automatikë në dorë. Na kërkuan që të ulemi nga makina dhe të dorëzojmë telefonat. Ne ashtu bëmë, sepse s'kishim rrugë tjetër. Shoferit i morën edhe portofolin ndërsa unë s'kisha para, por as pasagjerët e tjerë. Na urdhëruan që të ecim drejt dhe të mos kthenim kokën mbrapa. Na thanë që kush kthen kokën do të vritet. Ne vazhduam rrugën dhe kemi ecur në këmbë për rreth 50 min deri sa kemi shkuar te një lokal që është më poshtë dhe aty njoftuam policinë. Në ato momente kishim frikë dhe menduam se do vdisnim", tha Vogli. Ndërsa, shoferi Petrit Kërçit që e bën rrugën e Dukagjinit prej 27 vitesh deklaroi se nuk ka asnjë konflikt. Pas hetimeve paraprake 6 persona janë shoqëruar mes të cilëve dyshohet se janë 3 autorët e grabitjes. Tre shtetas nga të shoqëruarit janë nga Shoshi i Dukagjinit dhe tre të tjerë nga Pulti. Nga të shoqëruarit deri tani policia nuk ka arrestuar asnjërin prej tyre, ndërsa vazhdojnë hetimet. Ngjarja ka bërë bujë te banorët e Dukagjinit, të cilët tashmë kanë frikë të udhëtojnë. Mes shkrepareve të maleve, rruga është tërësisht e amortizuar, pa ndriçim dhe as nën monitorimin e policisë.



bashkëpunimi
gjerman
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEITUNG

Implemented by



giz

Programme: Sustainable Regional and Economic Development, Employment Promotion and VET

Programme: Sustainable Regional and Economic Development, Employment Promotion and VET
Die Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The objective of the programme reads: "The employment situation for employees and self-employed, especially qualified young people, is improved." The programme follows a nation-wide approach. It has four fields of activity: (i) Vocational Education and Training, (ii) MSME Promotion, (iii) Social Initiatives and (iv) Investment Promotion & Policies and Strategies for Employment Promotion.

The component, "Vocational Education and Training" (TVET), aims to enhance the quality of vocational training and education and bring it closer to match the labour market demands. Thus it contributes to the implementation of the National Employment and Skills Strategy (NESS 2014 – 2020), focusing on the Strategic Priority A: "foster decent job opportunities through effective labour market policies" and Strategic Priority B: "Offer Quality vocational education and training for youth and adults".

The second area of action, "Promotion of micro, small and medium-sized enterprises" (MSMEs), aims at building MSMEs capacities to generate economic growth with positive effects in employment, with an eye on improving growth conditions that have an impact on employment and the increase of supply and demand for skilled workers. To that end, the programme will cooperate with clusters of micro, small and medium-sized enterprises, as well as with the business representative associations.

The third area of action, "Social participation of youth and minorities", aims to support civil society social initiatives, focusing on the marginalized youth and teenagers.

The fourth area of action, "Strategies and frameworks for regional development, economic growth and employment", aims at enhancing conditions for the implementation of relevant strategies and projects within selected ministries and their subordinate institutions, like, for example, the Business and Investment Development Strategy 2014 – 2020, and the National Employment and Skills Strategy (NESS 2014 – 2020). The programme will play an advisory role on the cross-cutting issues of the first and second areas of action, with particular focus on employment-related issues.

ProSEED builds on the integration of three previous projects, "Vocational Education and Training (Jan 2015 – Dec 2016)", "Increasing the competitiveness of MSMEs by promoting innovation and entrepreneurship (ProSME, Oct 2014 - December 2016)", and "Economic Good Governance for Improving the Investment Climate" (Mar 2015 - Feb 2017). While the three forerunning projects covered certain segments in the area of promoting economic growth and employment (from the perspective of the labour offer, labour market demand and general conditions) through isolated interventions, the new programme intends to advance the approach applied so far and extend its scope by way of including new approaches aimed at employment promotion. In this context, the activities are complementary and favour a better matching of labour supply and demand match. The programme overall term is three years, starting from January 2017 until December 2019 (three years).

The programme contributes to reducing structural unemployment and underemployment, and to meeting the demands of the private sector with skilled workers. In this way, it tackles a thematic area of particular relevance to Albania and its further social and economic development.

GIZ Office Albania seeks the following staff:

Programme Coordinator: Synergies between VET and Entrepreneurship

A. Responsibilities
The incumbent holds autonomous responsibilities for his/her field of intervention in the implementation of ProSEED. The Programme Coordinator is responsible for:

- Management of programme activities according to programme goals, operational planning and agreements with the partner structure, namely the Ministry of Finance and Economy and subordinate agencies. This implies planning, budgeting, implementation and contribution to monitoring of measures as well as provision of advice to partners in close coordination with the leadership of the programme.
- This entails the management of two intervention areas (i) provision of VET through private training providers and (ii) provision of entrepreneurship trainings. In both cases, the trainings are delivered by external institutions/experts but are to be accompanied and coordinated by the incumbent.
- The incumbent will foster the realization of synergies amongst two components of the ProSEED programme, namely VET and Private Sector Development. Fostering exchange of concepts, coordination at participants' & geographical level and

creating innovative ideas on how to exploit synergies amongst the components (also including the work with socially disadvantaged youths).

- Contributions to knowledge management, monitoring and PR of ProSEED.
- Management of GIZ tasks as assigned per need.

The Programme Coordinator performs the following tasks:

B. Tasks

1. Management and Coordination tasks

- Manages program activities according to program goals, operational planning and agreements with the partner structures. This implies planning & budgeting, implementation and monitoring of measures within and may entail the accompaniment of external experts. The focus is on work with private training providers and on entrepreneurship trainings.
- Leads on calls for proposals on private training providers and ensures the smooth implementation of measures providing high-quality trainings and both their quantitative and qualitative monitoring.
- Accompanies the entrepreneurship trainings under the CEFE-methodology and ensures both quantitative and qualitative monitoring.
- Conceptualises the exploitation of synergies between VET and entrepreneurship and facilitates their exploitation.
- Accompanies the financial and administrative issues regarding the assigned intervention areas in close coordination with the contract manager of the programme.
- Conceptualises, prepares and implements workshops, seminars, and other events on subjects that are related to the program's field of activities;

2. Communication and networking

- Assists GIZ-Programme Director in establishing and increasing ProSEED visibility among stakeholders for VET and entrepreneurship;
- Actively networks on behalf of GIZ in the relevant community;
- Communicates and channels local interests and aspirations and exchanges ideas and information for the benefit of the programme.

3. Knowledge management

- Assist in improving the program's knowledge management system and tapping into other knowledge management systems;
- Complex information about ongoing programme activities and ensures knowledge transfer and link-ages' exploitation especially among the ProSEED team;
- Prepares appropriate input to the various program reports/publications including annual reports; con-tributes to other reports required by the AV and the GIZ Headquarter

C. Required qualifications, competences and experience:

- Master's degree in Economics, Education, Social Sciences, Business Administration, or other relevant field.
- Work experience with regards to VET and entrepreneurship/MSME-support.
- Minimally 5 years of professional working experience in a similar position related to VET and entrepreneurship/MSME-support.
- Strong record of professional expertise in his/her field
- Excellent command of MS-Office
- Good working knowledge of modern telecommunication systems
- Language skills (must include Albanian & excellent spoken and written English)

Contract conditions:

- Full-time employment
- Programme office in Tirana
- Assignment period: until 31.12.2019

Please forward your application until **10th of December** to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de including the following information: Application letter, CV in English (Europass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates will be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!

Bilanci korrik-dhjetor, thatësira "rrënon" financat e OSHEE

Fatura e energjisë, 27.8 mln euro vetëm për dhjetorin

Për gjashtë muaj, kompania bleu 135.5 mln euro për energjinë

Ornela Manjani

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ka siguruar sasinë e kërkuar të energjisë për muajin dhjetor, ndërkohë që shuma e shpenzuar kap vlerën 27.8 milionë euro. Referuar raportit të OSHEE, çmimi me të cilin kompania ka siguruar sasinë më të madhe është dukshëm më i lartë se ai i një muaji më parë, duke qenë se mbi 222.000 MWh janë blerë me një çmim prej 93.36 euro, nga 75.98 euro që u pagua për muajin nëntor. Thatësira e tejkzgjatur si dhe rritja e konsumit për shkak të stinës së dimrit detyruan operatorin e shpërndarjes të rrisë kërkesën për muajin e fundit të vitit, ndërkohë që kjo u shoqërua edhe me një nga faturat më të shtrenjta për këtë vit. "Totali i energjisë elektrike të ofruar dhe kërkuar për t'u blerë nga OSHEE s.h.a. për çdo profil është si me poshtë: Profil: Lot 1, 93,000.00 MWh e konvertuar në vlerë monetare 6,688,969.00 euro, me një çmim mesatar prej 70.97 euro/MWh. Profil: Lot 222,704.00 MWh e konvertuar në vlerë monetare 21,153,259.00 euro, me një çmim mesatar prej 93.36 Euro/MWh", thuhet në dokumentin e OSHEE, i cili jep edhe detajet e procedurës. Ndërkohë, kompania OSHEE bleu për muajin dhjetor, përmes platformës "online", procedurat e blerjes së energjisë elektrike për muajin nëntor. Sasia e siguruar



Fotoilustruese

është rreth 270 mijë MWh, me një vlerë prej 21.7 milionë euro, e ndarë në dy lote. **BLERJET NË 6 MUAJ** Sipas të dhënave nga OSHEE, mësohet se që prej muajit korrik vlera e shpenzuar për blerje energjie vetëm nga Operatori i Shpërndarjes arrin në 107.7 milionë euro. Ndërkohë që, nëse shtojmë edhe shpenzimet për dhjetorin, atëherë fatura shkon në 135.5 mil-

ionë euro. Ndërkohë, për t'i ardhur në ndihmë blerjes së energjisë, Këshilli i Ministrave ka miratuar dy vendime, duke akorduar 3 miliardë lekë shtesë nga buxheti i shtetit si dhe duke aprovuar një hua prej 1 miliard lekësh për blerjet e nëntorit dhe dhjetorit.

RAPORTI

Nga të dhënat e 8-mujorit 2017, rezultoi se kompania ka një trend në rritje të energjisë

Fushata, kontrollet në të gjithë vendin

OSHEE ka nisur një fushatë kundër lidhjeve të paligjshme në të gjithë vendin. Vetëm gjatë javës së fundit janë evidentuar 46 raste të shkeljes së ligjit. Kështu, nga kontrollet e ushtruara nga OSHEE Vlorë mbi ligjshmërinë e furnizimit me energji elektrike dhe të sigurisë së sistemit të matjes, ka identifikuar dhe ka denoncuar në polici 19 persona për vjedhje të energjisë. Ndërsa në Shkodër kanë shkuar për hetim të mëtejshëm 22 abonentë, të cilët janë kapur në flagrancë duke vjedhur energjinë. Në Durrës po zhvillohet një aksion i gjerë mbi abonentët debitorë, duke pasur në fokus kontrollin dhe verifikimin e abuzuesve me ligjin ku janë gjetur në shkelje pesë abonentë.



së shitur dhe faturuar. "Rritja e energjisë së shitur si dhe ulja e nivelit të humbjeve ka ndikuar pozitivisht në rritjen e të ardhurave për OSHEE. Sasia e energjisë së shitur rezultoi me rritje 2.7% ose 1,2 miliardë lekë, në raport me 8-mu-

jinorin e 2016-s. Në total kemi rreth 42.7 miliardë arkitime, kurse niveli i humbjeve, po si 8-mujor ka zbritur në 27.5 nga 28.1 që ishte vitin e kaluar, duke mos harruar se 4 vjet më parë ishte mbi 44%", thuhet në analizën e OSHEE-së.

Analiza e AMF-së për periudhën janar-tetor

Kompanitë e sigurimeve paguan 30 milionë euro dëme

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare bëri me dije se rritja në tregun e sigurimeve ka vijuar edhe gjatë 10-mujorit të këtij viti, duke regjistruar një vlerë prej mbi 13 miliardë lekësh, ose 8.92 për qind në shumë e janar-tetor 2016. Numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti 1,042,340 me një rritje prej 15.32% krahasuar me periudhën janar-tetor 2016. Gjatë këtij viti, AMF ka pasur një fokus të veçantë tek pjesa e dëmeve që kompanitë duhet të paguajë si dhe tek detyrimet e tyre të prapambetura ndër vite ndaj palëve të treta. Në janar-tetor dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve arritën në rreth 4 miliardë lekë apo rreth 30 milionë euro, ose 15.80% më shumë se në periudhën janar-tetor 2016. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 2,472 milionë lekë, apo 61.69% të totalit të dëmeve të paguara bruto. **SIGURIMI** Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare bëri me dije se primet e sigurimit të detyrueshëm motorik gjatë periudhës janar-tetor

Dëmet e Paguara në Sigurimin Aksidentet dhe Shëndeti
Paid Claims in Accident and Health Insurance

Shoqëria e sigurimit <i>Insurance company</i>	Vlera (në mijë lekë) <i>Value (in thous. ALL)</i>		Ndryshimi <i>Change (in %)</i>		Pjesa ndaj Totalit <i>Share in total value (in %)</i>	
	2016	2017	17/16-1	2016	2017	
Dëme të Paguara Bruto / Gross Paid Claims						
Sigal Uniga Group Austria	187,188	320,351	71.14	48.48	47.32	
Eurosig	118,301	139,992	18.34	30.64	20.68	
Sigma Interallbanian Vienna Insurance Group	35,340.92	110,472	212.59	9.15	16.32	
Interstig Vienna Insurance Group	36,729	79,870	117.46	9.51	11.80	
Albseg	7,595	23,494	209.34	1.97	3.47	
Atlantik	302	1,677	456.11	0.08	0.25	
Insig	129	1,020	689.57	0.03	0.15	
Ansig	527	83	(84.17)	0.14	0.01	
TOTAL	386,112	676,960	75.33	100.00	100.00	

janar-tetor 2017 pati një ulje prej 6.28% të volumit të primeve të shkruara bruto, ndërsa numri i kontratave

pati një rritje prej 7.48% krahasuar me periudhën janar-tetor 2016", thuhet në njoftimin e AMF.

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ
Permbaruesi gjyqesor privat Ermir Godaj zhvilloi ankandin për shitjen e pasurisë së palajshme "Pyll me sipërfaqe totale 551 m², me Nr. Pasurie 629/6, Volumi 9, Faqe 157, Zona Kadestrale 2460, e ndodhur në Lincze, "Tirane", e lene kolateral për garantimin e kredise, për shlyerjen e detyrimit në favor te kreditort ProCredit Bank Sh.a., per shumen 1'202'701.28 (nje milion e dyqinda e dy mije e shtatend e nje pjese rizeste e tete)Leke.
Çmimi fillësar me të cilin fillon ankandi është në shumën 5'730'400 (pesë milion e shtatend e tridhete mije e katenddhjetë)Leke, e konvertuar në monedhen Euro sipas kursit fikse te kombimit vektor te Bankes se Shqiperise ne daten 02.10.2017 (1 euro = 133.76 leke), në shumën 42'840 (dyzetë e dy mije e tetend e dyzetë)Euro.
Ankandi zhvillohet ne date 06.12.2017, ora 16.00 ne zyrën e përmbaruesit gjyqesor privat Ermir Godaj, rruga Abdi Toptani, qendra Torre Drin, kt.2,nr.33,Tirane, dhe per informacion mund te kontakton ne nr.0682099471,0695370060, email ermirgodaj@zyrapermbarimit.com.



Elion Semanaj

Ndryshimet te Hipotekat

Largohet kryeregjistruesja Doracaj, vjen Elion Semanaj

Në kuadër të ndryshimeve në Hipoteka është zgjedhur kreu i ri i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Palajshme. Blerina Doracaj është larguar nga detyra në krye të Hipotekës dhe në vend të saj emëruar Elion Semanaj. Kryeregjistruesi i ri është zgjedhur me konkurs, i cili u hap ditë më parë. Elion Semanaj u prezantua ditën e sotme nga ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj. Në korrik të këtij viti, kryeministri Rama u kërkoi dorëheqjen drejtoreshë të Hipotekave në të gjithë vendin, pasi sipas tij nuk e kishin bërë siç duhet punën për të cilën ishin ngarkuar. Blerina Doracaj u emërua në krye të Hipotekave në 20 korrik 2017, pas shkarkimit të drejtorit teknik Arjan Bylykbashi, i propozuar nga PD që nga marrëveshja 'Rama-Basha' më 18 maj.

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ
Permbaruesi gjyqesor privat Ermir Godaj zhvilloi ankandin e dyte per shitjen e pasurisë së palajshme "Apartamenti" me Nr. Pasurie 52304-1-8, Zona Kadestrale 8513, Vll.14, Fuq.89, me sipërfaqe 52.02 m², te ndodhur ne P.Sorrah17, Pall.978/1, Shk.1, Ap.8, Durrës, e lene kolateral për garantimin e kredive, për shlyerjen e detyrimit në favor te kreditort ProCredit Bank Sh.a., per shumen 1'961'130.58 (nje milion e nentend e gjashtëdhete e nje mije e njoqind e tridhete pjese pasedhete e tete)Leke dhe 33.63 (tridhete e tre pjese gjashte) Euro.
Çmimi me të cilin fillon ankandi i dyte është ne vleren 15'680 (pesendhete mije e gjashtëqind e tetëdhete) Euro.
Ankandi zhvillohet ne date 05.12.2017, ora 16.00 ne zyrën e përmbaruesit gjyqesor privat Ermir Godaj, rruga Abdi Toptani, qendra Torre Drin, kt.2,nr.33 Tirane, dhe per informacion mund te kontakton ne nr.0682099471,0695370060, email ermirgodaj@zyrapermbarimit.com.

PERSONAZH



Ka shënuar 81-vjetorin dhe është i vlerësuar me disa çmime. Artisti i njohur, ikonë e valles popullore vjen në një rrëfim për jetën e tij, prej fëmijërisë e deri sot

Besim Zekthi

Në shtëpinë me orendi komuniste të "Nderit të Kombit"

Fatmira Nikolli

Valltari: Kam pasur jetë të bukur dhe të lodhshme, vallen e nisa që fëmijë nëpër dasma

"Njohja dhe martesja me Sadijen, në dasmë na erdhi e gjithë Tirana"

Fëmijë, ai kërcente nëpër dasma. Tiranasiit hapnin dyert dhe në oborr ahengu vazhdonte gjatë në gëzime familjare. I vogël ka qenë natyrë e hedhur. I gjatë, i dobët, i shkathët, gjithnjë në humor, në fëmijëri ai nuk zinte vend dhe vallet i kishte pasion. Lala dhe Ija gëzonin kur e shihnin të birin, por asnjëri nuk dinte t'i merre vallet. "Ija ishte më qejflie, ndër-sa lala ishte më i sertë. U pëlqente kur më shihnin, por vetë nuk i dinin vallet", thotë ikona e valles popullore Besim Zekthi, sot "Nder i Kombit" në një bisedë për "Gazetën Shqiptare".

Sot, në moshën 81-vjeçare, Besim Zekthi jeton në një pallat të vjetër në rrugën "Mihal Grameno" në Tiranë.

Kam folur dy a tri herë në telefon me Zekthin, kam pyetur nëpër lagje derisa mbërrij në shtëpinë e tij.

Shkallët me pllaka në ngjyrë



Në foto: Besim Zekthi me Presidentin Ilir Meta

gri të çojnë në kat të dytë, ku derën e hap Sadija, bashkëshortja e tij dhe dikur, spikere e Ansambllit Popullor.

Kanë të njëjtën shtëpi që kanë ndërtuar me punë vullnetare në

rini, të dy burrë e grua. Dy dhoma e një kuzhinë, me hapësirë modeste dhe një arredim po aq modest. Në korridor, një portmonto minimaliste. Dyert janë të drunjta e të bardha, me një pjesë xhami në mes.

Ju duhet t'i mbani mend ato dyert. Janë kaq të vjetra, sa i gjeni kryesisht në filmat shqiptarë bardhezi. Mobiliet po të kohës së rinisë së tyre, të vogla, të thjeshta, prej druri. Bufeja, po si atëherë. Është e ulët dhe në të janë vënë me rregull gota të ndryshme. Është paradite, por dielli nuk bie në dhomë. Në shtëpi, syri të zë një kalorifer për ngrohje, ndërsa nga dhoma matanë, veshi të kap zërin e një televizori.

Kjo është shtëpia e "Nderit të Kombit" - krejt e zakonit, krejt e thjeshtë, si ajo e pensionistëve normalë, që me kontributet e tërë jetës, e shkojnë pëlerinë duke ndarë ato pak të holla që marrin mes ushqimit e ilaçeve. Nuk prisja ta gjeja Besim Zekthin të jetonte mes luksit, ai ka jetuar në Shqipëri, dhe ata që e njohin e përshkruajnë si një burrë të ndershëm. Ai nuk është marrë me politikë, as me biznes. Por, nuk prisja gjithsesi ta gje-



ja në këtë shtëpi, kaq modeste. Perceptimi i parë që të vjen në mendje kur do të shkosh në shtëpinë e një artisti në zë, është ai imazh që i jep qoftë titulli "Mjeshtër i Madh", qoftë "Nderi i Kombit". Në mënyrë krejt të pajustificueshme, nënvetëdija duket se të shtyn të mendosh se një njeri i madh, me emër të madh, që ka bërë punë të mëdha, që ka fituar aq shumë çmime, që ka ngritur në këmbë stadiume spektatorësh me vallet e tij, duhet të ketë, një shtëpi njëfarësoj të madhe, të bardhë, me drita që llamburinë. Por jo. Jam gabim. Jam në shtëpinë modeste të një burri të madh, që ka pasur siç thotë "një jetë shumë të lodhshme, por shumë të bukur". Gjithë ç'ka fituar mes ushqimit e moralit e shpirtërorit. Higjigj materiale. Janë ende të freskëta imazhet e shtëpisë së Robert Ndrenikës, që u bënë viralet për thjeshtësinë në të cilën jetonte. Duket se ai brez, që bëri art me emër, nuk mundi kurrë të bëjë edhe para, para aq sa u takon emrave që mbajnë.

Besim Zekthi është një burrë krenar. Nuk ia ka ënda të më flasë për shpërblimet e munguara në para, kur është kthyer nga jashtë me çmime e medalje të arta. Edhe titulli "Nderi i Kombit" nuk ka shpërblim monetar. Gjithë titujt që ka marrë kanë bërë që pensioni i tij të jetë diç më shumë se të tjerët. Shkon në jo më shumë se 40 mijë lekë të rinj. Ç'komb dhe ç'vlerësim për nderin e vet.

FËMIJËRIA

"Kam mësuar të kërcëj nëpër dasma në Tiranë" thotë Zekthi, duke shtuar se më pas shkoi në ansambël, ku punoi tërë jetën, 50 vjet.

Kujton se në dasma kërcente valle tiranase, valle të tjera popullore shqiptare, devollitje, dropulite, mirditore, kuksiane, dibrane...

Në dasma shkoja me ijen e me lalën, por edhe me shokë. "Lala kishte shumë kënaqësi kur më shihte të kërcëja. Ky do bëhet artist thoshte. Isha shumë impulsiv si temperament, më rrëmbente muzika". Ishte njeri i mbyl-

81 VITE JETË, ÇFARË SHËNON KARRIERA E TIJ



Në foto: Besim Zekthi

krijohet dhe Ansambli i Këngëve dhe Valleve Popullore, të cilin e drejtojnë "Artisti i Popullit", Çesk Zadeja. Vallja popullore në ecurinë e saj, si traditë dhe vlerë kombëtare shqiptare nuk mund të kuptohet pa përfaqësuesin e saj më të spikatur, Besim Zekthi. Artikulimet për Zekthin janë të shumta, veç morisë së çmimeve, titujve dhe nderimeve, që e kanë ndjekur për katër dekada.

Tek ai, arti në tërësi dhe vallja në veçanti kanë skalitur tiparet e një personazhi që rrezaton. Nga viti 1957 deri në vitin 1990, ai numëron mbi 200 valle të interpretuara si solist, duke realizuar me qindra figura artistike, të cilat janë të fotografuara në memorien artistike të gjithë shikuesve në mbarë brezat shqiptarë. Shkathtësia, mprehtësia, impulsi dhe dinamika e mjeshtërit të madh kanë mahnitur mijëra e

mijëra spektatorë. I cilësuar si kërcimtar plot temperament, energjik, i lehtë, me një mimikë shumë të pasur dhe ekspresive. Jeta e tij artistike është e lidhur fort me jetën koreografike të Ansambllit Popullor. Këtë e kanë vërtetuar një seri vallesh të vëna në skenë me sukses të plotë nga artisti i madh. "Dasma e Rugovës", "Për flamur, për atdhe", "Valle me motive të Mirditës", "Valle me motive të Drenicës" etj., janë disa nga veprat e vëna në skenë me koreografi të mjeshtërit. Edhe jashtë kufijve të vendit, Besim Zekthi ka debutuar me shumë sukses në vende të ndryshme të Ballkanit, Europës, Azisë dhe Afrikës.

Për talentin, punën dhe virtuozeitetin në interpretimin e valleve popullore, është vlerësuar me dhjetëra çmime dhe trofe të ndryshëm, deri tek ai i fundit, duke mbajtur sot titullin "Mjeshtër i Madh".

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND
 Ne date 04.12.2017 ne oren 16.00 ne zyrën e permbaresit gjyqesor privat **Irisa Tereziu PF** me adrese ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se palauajshme te llojit "Apartament" me sipërfaqe 52.01 m², me volum 1, faqe 175, numer pasurie 1/214-2-15, ne zonen kadastrale 1664, me adrese Lagjia "Puntori", Pll.14, Shk.2, Kt.3, Ap.15, Fushe Kruje.Cmimi ne ankand te dyte eshte ne vleren 1,361,671.36 (nje milion e treqind e gjashtedhete e nje mije e gjashteqind e shtatedhete e nje milion e nje pike tridhete e gjashte) lekë.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND
 Njoftim: Ne date 01.12.2017 ne oren 16.00 ne zyrën e permbaresit gjyqesor privat **Irisa Tereziu PF** me adrese ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se palauajshme te llojit "Apartament" me sipërfaqe 52.01 m², me volum 1, faqe 175, numer pasurie 1/214-2-15, ne zonen kadastrale 1664, me adrese Lagjia "Puntori", Pll.14, Shk.2, Kt.3, Ap.15, Fushe Kruje.Cmimi ne ankand te dyte eshte ne vleren 1,361,671.36 (nje milion e treqind e gjashtedhete e nje mije e gjashteqind e shtatedhete e nje milion e nje pike tridhete e gjashte) lekë.

SHPLLAJE ANKANDI
 Shoqëria Përmbarrimore "Enforcement Group" sh.p.k. shpall ankandin e parë për pasurinë e palauajshme të llojit Ndërtës, me Nr. 213/33-ND, volumi 17, faqe 150, ZK 3976, me sipërfaqe 240.50 m² çdo kat, vitë 4 katëshe, adresa e pasurisë Shkozë, Tiranë, në pronësi të Remzi Adil Muça. Çmimi me të cilën del kjo pasuri në ankandin e parë është 60,028,800 (gjashtëdhjetë milion e njëzet e tetë mijë e tetëqind) lekë. Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarrimore "Enforcement Group" shpk, në adresën Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla Nr. 1, Pallatet e Shoqërisë "Gora", Kati 3, Ap. 14, Tiranë në datën 30.11.2017, ora 16.00.
Për kontakt: Cel: 0692087566; email: enforcementgroup2014@gmail.com



Në foto: Besim Zekthi gjatë marrjes së dekoratës

MARTESA

Sadija dhe Besim Zekthi janë njohur në teatër. Atëkohë, ajo sapo kish mbaruar Liceun Artistik për art dramatik. Kishte shkuar te Teatri për të bërë prova që të shkonte në Akademinë e Arteve. Në një prej herëve që shkoi në teatër njohu edhe Besim Zekthin. Çifti nuk jep shumë detaje se si u bënë të afërt. "Ishte i bukuri i dheut", thotë e shoqja duke qeshur, "por edhe unë isha pak e mirë. Ja u njohëm, u fejuam dhe ikëm 3 muaj në turne në Kinë dhe në Kore", thotë Sadija.

Kur e pyes Zekthin se çfarë i bëri përshlytje tek e shoqja, më sheh dhe mendon një hop. "Paraqitja e saj më bëri përshlytje. Pastaj Sadi-



jur, po vetë nuk i ka mësuar gjë. "Ija ishte qejflie, por nuk dinte të kërcente. Kënaqësia e jetës së tyre ishte të më shihnin mua kur kërcëja". Po si bëhesh muzikë atëherë e pyes. "Me gramafon, ose merrnin instrumente popullore. Sipas krahinës". Shtëpitë e qerpiça e kanë parë disa herë Zekthin të djegë shaminë e beqarit nëpër valle. Në fillim shkoi në Filarmoni. Mësoi nga profesorë të ndryshëm deri te rusi Georgi Perkumi. Nga Filarmonia më 1957, shkoi në Ansamblin e Shtetit. Ishte rritur e kishte bërë emër. Ishte tanimë solist dhe binte në sy. "E kisha dhunti të bëja në sy. Isha shumë i gjallë".

Si një ndër yjet e Festivalit të Dizhonit nga ku ansambli mori "Gjerdanin e artë", Zekthi ka shumë kujtime. Kërceu te "Vallja e shqipeve" dhe "Festë ka sot Shqipëria". I yni, ishte një nga an-

samblet më të dalluara të botës, kujton, por shqiptari shkëlqeu, duke u quajtur "stuhia shqiptare". Megjithatë, shteti shqiptar nuk u dha shpërblim atëherë, i çoi vetëm dy javë në Durrës në plazh. Në Francë qëndruan dy javë. Një burrë i gjatë, simpatik, brun, me shpatulla të gjera, ai binte në sy edhe nga pamja. Admirueset ishin disa. Fotografite e tij të rinisë tregojnë të printuar në letër një burrë tërheqës, që ravijëzonte tiparet e një aktori perëndimor; nga ata të posterave.

ja më dukej shumë e afërt. Më dukej sikur e kisha njohur prej kohësh". Kujton se bisedonin me kënaqësi me njëri-tjetrin dhe me besim. "Po. E desha menjëherë". I kujtoj se ka qenë një djalë i gjatë, i bukur, solist që binte në sy në një teatër plot me vajza dhe më pas e pyes se si mundi një vajzë si Sadija ta bënte papritur për vete, kur si 18-vjeçar shkonte vetëm të bënte prova në teatër. "Vajza kishte plot aftësi, por ishte natyra e saj që më bëri për vete. Por edhe simpatike ishte, edhe e qeshur ishte". Kur e pyes

nëse valltaret a balerinat e ngacmonin, Besim Zekthi, bëhet kaq sportiv. Qesh dhe i kujtohet se si kur u fejuan, një shoqe nga Ansambli i tha: Po ç'ke atë, ç'deshe që u fejuave me Sadijen, ajo është racë tjetër. Zekthi atë kohë i kishte thënë: Ku di unë ç'është ajo.

Dasma e tyre ka qenë shumë e bukur. "Kishte ardhur e gjithë Tirana për të parë dasmën. Ne kishim hapur dyert dhe dasma u bë tek oborri i shtëpisë së nënës sime. Kam kërcyer gjithë kohën. Të gjitha vallet bashkë me Sadijen", kujton me nostalgji Besim Zekthi.

E pyes nëse më pas iu bë përkrahje. "Ah, po sigurisht. Shumë e aftë. Jash-tëzakonisht e aftë. Kemi kaluar jashtëzakonisht njëri-tjetrin. Jemi dashur shumë dhe e kemi respektuar pa masë njëri-tjetrin". Kthehem dhe shoh Sadijen nëse bashkëshorti po thotë të vërtetën dhe ajo qesh e pohan. E pyes, nëse Zekthi ka qenë natyrë e vështirë në marrëdhënien me tyre.

"Ka qenë pak natyrë e vështirë, sepse ishte impulsiv. Por, unë isha natyrë tjetër dhe toleroja. I jepte edhe fama pak bezdi, ishte në piedestal. Por unë isha 15 vjetë spikere e ansambli. U martuam, u bëmë me fëmijë. Kemi tri vajza. Atij i kanë ngjarë. Po asnjëra nuk është valltare.



Në foto: Besim Zekthi në skenë, gjatë interpretimit në vite



Nuk donim, sepse është profesion i vështirë për vajza, sidomos kur bëhen nëna", thotë Sadija. Zekthi pohan se është sakrificë për një grua të jetë valltare.

E pyes nëse i ka bërë dhurata të shoqes. Pohan dhe thotë se shkonin bashkë nëpër udhëtime jashtë.

"Udhëtimet nuk më bënin përshlytje. Banketet ishin të mira. Por lodheshim shumë. Nuk iknim dot me autobus se kishte radhë për autografe", thotë Zekthi.

Ka qenë një turne në Francë. Kujton se njëherë para një shfaqjeje në Paris, u thanë se është vënë bombë. Dolën të gjithë jashtë nga teatri dhe u prit derisa u kontrollua i gjithë ambienti. Më pas publiku u kthye në sallë e artistët në skenë. Sukseset ishin të mëdha. Shpesh shfaqjet bëheshin edhe në stadiume. I gjithë stadiumi ngrihej në këmbë. Në Kosovë madje digjnin rrobat dhe i tundin. A ka qenë jetë e bukur e pyes? "Po, e lodheshme, por shumë e bukur, kam marrë shumë kënaqësi", thotë Zekthi. Nuk ka pasur probleme me regjimin. Sigurisht që në çdo grup që shkonte jashtë, kishte edhe nga ata të Sigurimit, por asnjë problem a pengesë. Ka kërcyer 'Osman Takën', shihte valltarë të vjetër e të rinj, vizitonte fshatrat për të marrë frymëzim. Ansambli sot? Sipas tij ka nevojë për vëmendje dhe për punë, por ai nuk do që të ndalet gjatë. Si natyrë krenare, nuk i pëlqen të flasë për çka nuk shkon, madje ndërron temë.

UNESCO i përgjigjet letrës së ankesës së grupit të artizanëve në Butrint. Forumi i Trashëgimisë ka publikuar letrën e dërguar dje nga qendra e pasurive botërore të UNESCO për këtë grup, i cili po ankohet se Ministria e Kulturës po i përzë nga Butrinti në favor të një biznesi privat. Sipas Forumit, konfirmohet dhe njëherë se krijimi i qendrës së artizanatit të Butrintit ishte pjesë e një projekti të mbështetur nga Banka Botërore në vitin 2003-2004 dhe për gati 15 vite ka funksionuar si një mundësi punësimi për gati 40-50 familje të varfra të zonës, të cilat siguronin jetesë me prodhime të bëra vetë. Ndërkohë, Forumi shton se, ministria Kumbo me një kontratë të bërë jo publike i jep të drejtën një kompanie private (e njëjta me atë që kërkon të bëjë edhe restorantin në Akropol) të ndërtojë një qendër të re dhe të administrojë të gjithë pjesën e suvenireve. "Megjithëse ministria e justifikon këtë me rritjen e cilësisë, fakti është që kjo ministri nuk ka bërë asnjë përpjekje për të bashkëpunuar me artizanët e Butrintit për të rritur cilësinë e prodhimeve", - nënvizon Forumi. Ai shton se, ministria Kumbo mendon se një biznes nga Tirana (për koincidence ndan të njëjtën hapësirë në një fshat turistik në Golem) mund të administrojë si restorantin në Akropol, si pikën e suvenireve. "Arsyeja se përse Kumbo mendon kështu nuk është bërë asnjëherë publike. Nuk ka pasur asnjë përpjekje për të ndihmuar 50 familje të varfra për të jetuar me punën e tyre, nuk ka pasur asnjë konkurs për të përzgjedhur biznesin që mund të ndihmonte këtë pikë suvenieresh", - shkruante dje Forumi për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore. Sipas tij, ajo që është më e rëndësishme fakti se qendra e artizanatit është mbështetur nga Banka Botërore për të ulur varfërinë në zonë si dhe mbështetur nga fondi italian i kulturës. Ky projekt i kërkuar dhe implementuar nga Parku i vitit 2003, ishte në përputhje me politikat e UNESCO për të ndihmuar komunitetet e varfra përgjatë zonave të pasurive botërore.



FOTOLAJM

Njoftim për shitje me ankand
 Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin për pasurinë e debitorit V Gjikas, P Gjikas
 Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga:
 - "Aparatament" me numër pasurie 31/202-1-6 faqe 160 Val 44 , në ZK 8602 me sipërfaqe 63.19 m2 në Vlorë
 Ankandi i pasurisë fillon me cminin fillestar në masën 32.880 Euro Ankandi do të zhvillohet datë 07.12.2017 orën 15:00, selin e shoqërisë "pall Gorko" Bule "Gj. Fisha" Kulla 3, Tiranë Oretuesit duhet të tërheqin dokumentacionin të kontaktojnë me tel. 00355 67 20 82 543 ose e-mailit ilir_dervishaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice-al.com

MINISTRIA E DREJTËSISË
 DREJTORIA E PËRGJITHSHMË E PËRMBARIMIT
 ZYRA PËRMBARIMORE TIRANË
 Zyra e Përmbartimit Tirane, me përmbareues gjyqësor Albert Fejzo , në baze të vendimit nr. 10019, datë 16.11.2017, shpall shlyjen në ankand të pasurisë apartamentit të banimit me sipërfaqe 57 m2 të ndosur në Rrugën "Irfan Tomini", pallati 102/60 në Zonen kadastrale 8260 të regjistruar Zyra Vendore Regjistrimit Pasurisë Pallatishme Tirane me nr pasurie nr.254+4-60, vullme 6, faqe 82 Tirane, në vlerën 2.800.000 (dy milion e tetëqind mijë) Lekë.
 Ankandi zhvillohet në ambientet e Zyrës të Përmbartimit Tirane, në adresën : Sheshi Mustafa Ataturk, kryeqendri "21 dhjetori", Tirane ditën e Premte , me datë 08.11.2017, ora 16.00.

Shoqëria përmbartimore "AFA-2010" sh.p.k për shityjen e pasurisë së palajsthesme:
 Pasurisë me Nr.3/369 e llojit "Trrull + Banesë 3 katëshe" me sip. trrullit 350 m2 dhe sip. banesë 191,9 m2 (kati përdehe 191,9 m2, kati i 1269,03 dhe katili 269 m2) ndodhur në L. "11 Janari", ZK. 2310, Kuçovë në pronësi Agim Isa Zeqaku. Çmimi fillestar në ankandin e tretë është 10.060.000 Lekë. Ankandi zhvillohet në datën 18.12.2017, ditën e Hënë ora 15.30 në ambientet e Shoqërisë Përmbartimore "AFA-2010" sh.p.k në adresën Rruga "Sulejman Delvina", Nd.51, H.9, Ap.1, Tiranë.
 Për info. Tel:044503458 ose E-mail shoqeriparmbartimoreafa2010@gmail.com



Kushite në të cilat jetojnë vajzat e familjes Tabaku

"Jetojmë vetëm me 200 mijë lekëshin e KEMPI-t, nuk i blejmë dot as ilaçe"

Mes mjerimit dhe autizmit, historia e familjes Tabaku në Kuçovë

Voltiza Duro

Në fshatin Vodez të Kuçovës, në një dhomë të vogël plot lagështi, me dritare të thyera e mure të plasaritura jeton familja Tabaku. Tashmë që po vjen dimër, atyre u është dashur të izolojnë me ngjites xhamat e thyer në mënyrë që të mbrohen sadopak nga i ftohti, e njëkohësisht shpresojnë që këtë vit, moti mos tregohet po aq mizor sa shteti. Shiu futet brenda nga të katër anët e tavani pikon ujë mbi krevetat e dy vogëlusheve të kësaj familjeje. E si të mos mjaftonte e gjithë kjo, prindërit duhet të përballen përditë me një tjetër realitet edhe më të vështirë. Që në moshën 3 vjeçare vajza e vogël e familjes është diagnostikuar si një fëmijë me nevojë të veçanta të spektrit autizëm, por gjendja e mjeruar ekonomike e prindërve ka bërë që trajtimi për vogëlushen mos të jetë i plotë. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Laura Tabaku, nëna e fëmijës me autizëm që tashmë ka mbushur 6 vjeç, tregon se ajo dhe bashkëshorti nuk janë në punë dhe pagesa e KEMPI-t për vajzën prej 200 mijë lekësh të vjetër është i vetmi burim të ardhurash për të mbajtur frymën gjallë. Ajo, me lot në sy, bën thirrje për ndihmë ndaj instancave përkatëse, duke kërkuar të paktën t'i mbulohet shpenzimi i rrugës që duhet të bëjë përditë për të dërguar vajzën në qendrën shëndetësore të Beratit, për të ndjekur trajtimin me një psikolog.

Nëna: Na ndihmoni të kurojmë vajzën e sëmurë



Laura Tabaku, nëna e dy vajzave

REFRIMI
Jetojmë vetëm me pagesën e KEMPI-t prej 200 mijë lekësh të vjetër që merr 100 vajza, e 100 unë si kujdestare e saj. Por kjo nuk na mjafton për të blerë as gjërat që na duhen më shumë, sidomos ilaçet e vajzës së sëmurë.



Faksimile e vërtetimit që vajza e vogël merr KEMPI

të vogël që na e kanë dhënë vjehera me vjeherin. **Kjo dhomë është gjithëka që ju keni në pronësi!** Po! Këtu ne duhet të rrimë, të hamë, të gatujmë, të flemë, por kjo hapësirë nuk është e mjaftueshme për katër persona. Vajza e madhe, që është në klasë të dytë, duhet të mësojë e ne nuk i ofrojmë dot as një tavolinë ku të ulet të shkruajë. Kësh-

tu që ulet në gjunjë e shkruan në karrige për të bërë mësimet. **Si janë kushtet e ambientit ku jetoni?** Skandalozë, siç mund ta shikoni edhe vetë. Dritaret janë të vjetra, disa xhama të thyer që bashkë me burrin i kemi izoluar me ngjitëse që të mbajnë jashtë të ftohtin pasi edhe ngrohje nuk kemi. Tani që fillojmë shirat,

tavani pikon e duhet të vëmë legenë që të mbledhin ujën. Na mbyti lagështia e më shumë kam frikë për vajzat se mund të kapin ndonjë sëmundje. **Si e përballoni jetesën në Vodez nga ana ekonomike?** As unë, as bashkëshorti nuk jemi në punë. Unë duhet të rri gjatë gjithë kohës me vajzën e vogël që ka autizëm, madje shkoj edhe në

kopsht rri me të pasi nuk ka ndihmë të specializuar. Kështu që jetojmë vetëm me pagesën e KEMPI-t prej 200 mijë lekësh të vjetër që merr 100 vajza, e 100 unë si kujdestare e saj. Por kjo nuk na mjafton për të blerë as gjërat që na duhen më shumë, sidomos ilaçet e vajzës së sëmurë. Edhe librat e vajzës së madhe i bleva duke marrë lekë borxh dhe i kam larë kur kam marrë pagesën e KEMPI-t e tjetrës.

Kur u diagnostikua vajza juaj me autizëm dhe a po merr trajtim mjekësor?


Kur ishte 3 vjeç e morëm vesh që ishte me autizëm. Ky lajm na ra si bombë se nuk e prisnim. Për momentin e dërgoj në një qendër shëndetësore në Berat, por jo përditë, sepse rruga kushton 3 mijë lekë të vjetër e nuk na del llogaria. Kur kemi lekë shkoj bashkë me të dhe bën seanca me një psikolog.

A keni kërkuar ndihmë nga instancat përkatëse?

Unë kam trokitur në të gjitha institucionet e zyrat e shtetit dhe nuk më janë përgjigjur pasi më përcjellin me pretekstin se kam pagesën e KEMPI-t të gocës. Kam shkruar në komunën Lumas dhe i kam thënë të vijnë të shikojnë situatën. Më premtuan që do vijnë, por nuk erdhën dhe as më ndihmuan.

Cila është thirrja juaj ndaj shtetit?

I lutem që të më ndihmojnë, të paktën me transportin e rrugës që bëj deri në Berat kur çoj vajzën në qendrën shëndetësore. Gjithash-tu, kërkohet që burrit t'i sigurohet një punë pasi është tejet e vështirë ta gjejë në fshat.



160 mijë vullnetarë nisnin aksionin për pastrimin e vendit

Ka nisur ditën e djeshme aksioni kombëtar "Pastrojmë Shqipërinë që duam" nga 160 mijë vullnetarë në mbarë vendin. Pjesë e kësaj nisme janë bërë edhe nxënësit e shkollave, madje edhe anëtarët të kabinetit qeveritar. Në lidhje me këtë kauzë, kryeministri Edi Rama, i shoqëruar nga ministrja e Arsimit, Sportit e Rinisë, Lindita Nikolla, ministri i Bujqësisë, Niko Peleshi e ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj kanë qenë të pranishëm në Lushnje ku kanë dhënë ndihmën e tyre për pastrimin e këtij qyteti. Ndërsa ministri i Mjedisit, Blendi Klosi, nga Qesaraku e Tiranës kërkoi ndihmën e qytetarëve në pastrimin e vendit. Ky aksion do të zgjasë plot 6 muaj e ka si synim një Shqipëri më të pastër nga mbeturinat urbane që do të presë sezonin e ri turistik si asnjëherë më parë.



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 586

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE

Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 25 Nentor 2017

ÇILJETA & ALBANI SHFAQEN NE KRAHET E NJERI-TJETRIT



Të gjitha detajet e festës surprizë për 30-vjetorin e portierit

Çifti shuan zërat për ndarje, pozojnë së bashku

HUEYDA EL SAIED

Pas divorcit rigjen dashurinë



NDAHET ÇIFTI I "BB9" XHENI: JA PSE U NDAVA NGA BERNARDI



• "Nuk kishte kuptim të vazhdonim të kërcenim bashkë, prandaj u largova"

PRESIDENTI META MBLEDH VIP-AT NE "JAVEN E FEMIJEVE JETIME"



PIRRO ÇAKO NE NJE LIDHJE TE RE?

JA CILA ESHTË VAJZA MISTERIOZE
QE E BERI TE HARROJE SISIN



Në kuadër të veprimtarisë "Java e Fëmijëve Jetimë" që zhvillohet nën kujdesin e Presidentit të Republikës, Ilir Meta, në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Integritit të Jetimëve Shqiptarë, artistët e njohur Bes Kallaku dhe Xhensila Myrtezaj vizituan dje ekspozitën e hapur me këtë rast pranë Institucionit të Presidencës. Në aktivitetin ku morën pjesë nxënës të shkollave 9-vjeçare "Hillary Clinton" dhe "100 Vjetori i Pavarësisë", si edhe nxënës të gjimnazit "Ibrahim Rugova" në Kamëz, artistët e njohur Bes Kallaku dhe Xhensila Myrtezaj shprehën solidaritetin e tyre me fëmijët pa kujdes prindëror. Gjithashtu, ditën e enjte në kuadër të veprimtarisë "Java e Fëmijëve Jetimë", që zhvillohet nën kujdesin e Presidentit të Republikës, Ilir Meta, në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Integritit të Jetimëve Shqiptarë, një grup artistësh të njohur vizituan ekspozitën e hapur me këtë rast pranë Institucionit të Presidencës. Ardit Gjebrea, Soni Malaj, Venera Lumani dhe Lindi Islami vlerësuan

Presidenti Meta mbledh VIP-at në "JAVËN E FËMIJËVE JETIMË"

Ja aktivitetet që u organizuan

angazhimin e Presidentit Meta për organizimin e veprimtarisë ndërgjegjëse dhe solidarizimin e përkrahjen e tij për fëmijët pa kujdes prindëror. Në aktivitetin ku morën pjesë edhe fëmijët e Shtëpisë së Fëmijës "Zyber Hallulli" në Tiranë dhe nxënësit e shkollës së mesme "Samë Frashëri" në Tiranë, artistët e njohur Ardit Gjebrea, Soni Malaj, Venera Lumani dhe Lindi Islami shprehën solidaritet me fëmijët pa kujdes prindëror.



Çiljeta dhe Albani shfaqen në krahët e njëri-tjetrit


Të gjitha detajet e festës surprizë për 30-vjetorin e portierit

Pamela Aliaj

Do të duhej ditëlindja e 30-të e Alban Hoxhës, që ai dhe Çiljeta të shfaqeshin në një fotografi së bashku. Prej gati dy vjetësh dyshja e mirënjohur është përfolur për një lidhje mes tyre, duke u kapur shpesh nga paparacët në rrugët e kafenetë e Tiranës. Këngëtarja, por edhe portieri asnjëherë nuk kanë folur publikisht për lidhjen e tyre, duke e bërë edhe më konfuz publikun për marrëdhënien që kanë. Por duket se tashmë nuk ka asnjë dyshim, Çiljeta dhe Albani po jetojnë një dashuri të zjarrtë. Mbrëmjen e djeshme portieri i Partizanit ka festuar përvjetorin e tij të 30 dhe natyrisht që e dashura e tij i ka organizuar një festë me miqtë dhe të afërmit. Mes shumë



Çifti shuan zërat për ndarje, pozojnë së bashku



Duket se Albani dhe Çiljeta vijojnë të jetojnë raportin e tyre plot dashuri dhe duket se tashmë nuk i fshihen më as syrit të publikut

të ftuarve VIP, çifti nuk ka ngurruar të postojë edhe foto së bashku. Mes miqve të dyshes simpatike nuk munguan as gazetarë apo edhe personazhe të tjerë të njohur. Klodiana Shala, Eraldo Rexho, Ervin Kurti ishin vetëm disa nga të ftuarit e çiftit që ka vijuar festën deri në orët e para të mëngjesit. Me aq sa kemi mundur të mësojmë, ka qenë një festë e organizuar me të gjitha detajet. Tollombaze, kapele festive si edhe torta nuk ka munguar në përvjetorin e portierit tonë, që këtë përvjetor e ka festuar me miqtë dhe të dashurën. Kuj-



tojmë se marrëdhënia e tyre është përfolur shpesh në media, duke shkruar për bashkëjetesën apo edhe për ndarjen e tyre. Por, duket se Albani dhe Çiljeta vijojnë të jetojnë raportin e tyre plot dashuri dhe duket se tashmë nuk i fshihen më as syrit të publikut. Të dy janë prindër të dy fëmijëve të vegjël. Fernando është djali i Çilit nga historia e saj e mëparshme. Nga ana tjetër, edhe Albani është babai i vogëlushit Beko, nga martesja e tij me bashkëshorten e ndjerë, Dorina.

Konkurrentja e "Dance with me": Ju rrëfej si e priti produksioni largimin tonë

Ndahet çifti i "BB9", flet Xheni:


Ja pse u ndava nga Bernardi

"Nuk kishte kuptim të vazhdonim të kërcenim bashkë, prandaj u largova"



Pamela Aliaj

Ata kanë mbetur një ndër çiftet më të përfolura nga mediat e shkruara dhe vizive. Lidhja e tyre mori jetë brenda shtëpisë më të madhe të Shqipërisë, "Big Brother Albania9", por mesa duket historia nuk do të zgjaste përgjithmonë. Të shumta kanë qenë thashethemet nëpër portale për një ndarje të tyre të beftë por, Xheni e ka dhënë një përgjigje përfundimtare për t' i dhënë fund gjithë kësaj thashethemaje. Në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" ajo ka thënë se si qëndron e vërteta e lidhjes dhe e ndarjes së tyre. Xheni është shprehur edhe pse u largua nga "Dance with me" për të shkuar pastaj te prindërit në Itali. Por pse e gjitha kjo? A mund të ketë një rikthim të mundshëm? Gjithçka e gjeni në intervistën më poshtë.



Shumë thashetheme janë bërë lart e poshtë për ndarjen me Bernardin. Është e vërtetë që jeni

ndarë?


Nuk janë thashetheme. Po është e vërtetë, unë dhe Bernardi jemi ndarë.

Kur folëm me Bernardin tha që ishte një gabim i juaj që jeni zënë. Si qëndron e vërteta?

Pirro Çako në një lidhje të re? Ja cila është vajza misterioze që e bëri të harrojë Sisin

Pirro Çako, një ndër kantautorët më të njohur, ishte i ftuar në koncertin operistik të Migena Gjatës, motrës së madhe të këngëtares Elvana Gjata.

Në koncert ai është vënë re i pashoqëruar, teksa kishte ardhur për të ndjekur koncertin në skenën e Universitetit të Arteve në Tiranë, i veshur si gjithnjë në stilin "casual". Muzikanti 52-vjeçar ka gjetur një vend komod për t'u ulur e për të ndjekur koncertin e sopranos shqiptare, e cila zhvillon karrierën e saj jashtë vendit.



Por e veçanta e gjithë kësaj skene nuk ishte pjesëmarrja e tij në këtë shfaqje, por fakti se Pirro ishte vetëm fizikisht aty, pasi me mendje, ishte me një vajzë të re që shfaqej në ekranin e smartphone-it e tij, ndërkohë që po komunikonte virtualisht me të. Nuk

dihet se pothuaj 1 vit pas ndarjes ajo është e dashura e re e muzikantit, apo kemi të bëjmë me një flirt spontan e të rastësishëm. Në janar të këtij viti, Pirro i dha fund lidhjes 5-vjeçare me ish-të dashurën, me të cilën bashkëjetuan në shtëpinë e tij në



Tiranë. Kjo ishte lidhja e parë e konsoliduar e Pirros, pas daljes nga martesë e gjatë në Paris me sopranon Inva Mula, martesë nga e cila erdhi në jetë djali i tyre Antho-

ny. Nga ana tjetër, për sa i takon muzikës, Pirro aktualisht duket paksa i distancuar, ndërkohë që presim këngën e tij të radhës.



//
Nuk janë thashetheme. Po është e vërtetë, unë dhe Bernardi jemi ndarë. E vërteta është se thjesht nuk funksiononte më lidhja jonë, s'ka fajtor.

E vërteta është se thjesht nuk funksiononte më lidhja jonë, s'ka fajtor.

Kohët e fundit postimet e Bernardit në "Instastory" ngjasojnë me postimet e Jenit. Mos do të thotë kjo se jeni pajtuar?

Kjo gjë me postimet është

rastësi, s'kemi më lidhje me njëri-tjetrin.

Pse vendose të largoheshe nga "Dance with me"? Çfarë ndodhi?

Nuk kishe kuptim të vazhdonim "Dance with me" të ndarë kjo është arsyeja.

Po Bernardi ishte dako-

rd të largohet? Kush e mori vendimin?

Përdërisa ishim të ndarë vendimi më takonte vetëm mua. Edhe u largova.

A të tha gjë produksioni i "Dance with me" për këtë vendim? Ishte vendim i të dyve?

Produksioni respektoi vendimin tonë.

Vendimi për të shkuar në Itali ishte i papritur. Keni ndërmend të riktheheni sërish në Shqipëri?

Jo, është vendim i menduar mirë.

Të është ofruar ndonjë mundësi për të qenë pjesë e ekranit pasi dole nga

"BB9"?

Po të më kishin dhënë mundësinë do më kishit parë në ekran.

Me çfarë merreni tani që jeni kthyer në Itali?

Për momentin jam duke rregulluar disa gjëra për një të ardhme.

Lajme të mira për Hueyda El Saied, pas divorcit rigjen dashurinë



Para pak kohësh ajo lajmëroi divorcin nga babi i djalit të saj Gabriel, por mesa duket Hueyda El Saied, një nga bukuroshet e mediave rozë, ka rigjetur dashurinë.

Ndërkohë që Revistawho.com ka arritur të kapë "mat" showgirl-in



shqiptar, Hueyda El Saied në krah të partnerit të saj të ri. Hueyda para pak kohësh, e ftuar në "Lart e poshtë" nuk

ka dashur të flasë më tepër lidhur me këtë histori dashurie.

"Ku e keni kapur këtë foto?!"



E keni bërë këtë foto para të hënës. Ai është shoku im, nuk është shqiptar. Dashuria ime e parë dhe shpresoj të jetë e

fundit", -ka thënë Hueyda që dukej shumë e dashuruar pas gjithë problemeve të kaluara para pak kohësh.

Laura Nezha lezbike?

Befason aktorja: Do të sfidoj veten



E dhe pse nuk i pëlqen të lëvdohet për format e saj trupore, nuk ka se si të mos i shpëtojë mediave rozë.

Bëhet fjalë për bukuroshen Laura Nezha, e cila, e ftuar në një emision, ka folur për herë të parë për mjediset e biznesit të saj, por njëkohësisht ka folur edhe për projektet e saj në muzikë e teatër.

Kënga e saj e fundit "Je dashuri" duket se u mirëprit nga publiku, edhe pse bukuroshja bionde vendin e saj e ka në skenën e teatrit, por nuk haron t'i rikthehet edhe muzikës.

Ndërkohë që e pyetur nga gazetarja në emisionin "Lart e poshtë" nëse do të pranonte një rol nudo ajo është përgjigjur:

"Nuk e kam parë të arsyeshme dhe nuk mendoj se është zgjedhje e përshtatshme. Por ama do të bëj role që sfidoj veten dhe i radhës është në shfaqjen "Shërbëtorja" ku unë duhet të luaj rolin e një vajze të izoluar, që ka trysni të forta, madje i duhet të ndryshojë edhe drejtimin seksual", -ka thënë Laura.



Një ngjarje e rëndë dhe e papritur ka ndodhur ditën e sotme në SHBA, ku këngëtari i njohur, Noizy është përfshirë në një sulm gjatë një koncerti të tij në një nga lagjet më të njohura të saj.

Ai është sulmuar nga grupi rival CFE gjatë një koncerti, që ka pasur në Queens, të Nju Jorkut.

Një nga fansat e tij, që ishte pjesë e koncertit, ka filmuar me anën e një videoje që e ka postuar më vonë gjithë ngjarjen e ndodhur. Në video pretendohet se një reper krejtësisht i panjohur, emri i të cilit është "Don Phenom", bashkë me grupin e tij "CFE", kanë sulmuar Noizin ka shkruar një faqe në "Facebook" "Hip Hop Shqip", e cila ka publikuar këto pamje.

Edhe pse në videon e publikuar nuk shihet qartë Noizy, i cili deri më tani nuk ka dhënë asnjë detaj lidhur me



Plas sherri mes reperëve në SHBA, në rrezik jeta e Noizyt

Fansat e Noizy kanë qenë shumë të shqetësuar dhe shumë të vëmendshëm me gjithë zhvillimet që po ndodhin lidhur me reperin e njohur

këtë ngjarje. Ndërkohë që pretendohet se reperin i famshëm shqiptar ka qenë i rrethuar nga siguri i klubit ku ai do të mbante koncertin e tij, ka qenë i shoqëruar edhe nga disa forca policore të Nju Jorkut "NYPD", të cilat garantonin sigurinë e tij.

Por jo më larg se para dy muajsh, reperin është përfshirë në një tjetër sherr ku kësaj radhe ka qenë ish-dashuri i Tunës, Cozman, i cili ka përballë Swiss Diamond Hotel ka ndodhur një përleshje me armë në mes të dy grupeve të reperëve.

Siç mëson gazeta "Zëri" të përfshirë në këtë përleshje kanë qenë reperin nga Shqipëria Noizy, së bashku me grupin e tij kundër ish-të



dashurit të Tunës, Cozman.

Të dy palët kanë gjuajtur me armë në drejtim të njëri-tjetrit ndërsa nga këto të sh-tëna ka mbetur i plagosur një shok i Noizyt.

Por nuk kanë vonuar të vijë në vendin e ngjarjes policia e Kosovës, e cila ka arrestuar ish-të dashurin e Tunës, Cozman. Ndërkohë në vendin e ngjarjes është paraqitur edhe ambulanca, e cila ka marrë personin e plagosur për trajtim në spital.

Mesa duket Noizy nuk mund t'u qëndrojë larg problemeve të tilla dhe duket sikur po e "gjurmojnë" kudo që ai ndodhet. Fansat e tij kanë qenë shumë të shqetësuar dhe shumë të vëmendshëm me gjithë zhvillimet që po ndodhin lidhur me reperin e njohur. Çfarë po ndodh me Noizyn ende nuk është e qartë dhe ai ka zgjedhur të mos japë asnjë shpjegim lidhur me ngjarjen e fundit.

Opinion *i* Ditës

Nga Fisnik Zicishiti

(Vijon nga faqja e parë)

... në rrugët e vendit tonë çdo ditë humbin jetën ose plagosen rëndë qytetarë të pafajshëm, vetëm se drejtuesit e mjeteve dhe këmbësorët nuk zbatojnë rregullat e qarkullimit.

Përse vallë? Përse gjithë këta njerëz të gjymtuar? Vallë mos na kanë mallkuar si komb? Përse nuk mblidhet komisioni ndërministror për sigurinë rrugore, i cili ka kohë pa u mbledhur e të vendosë pikat mbi "I", përse vallë? Përse kryetarët e bashkive nuk po i japin rëndësinë e duhur sigurisë rrugore, mos vallë ka diçka me më rëndësi se sa jeta njerëzore? Përse Ministria Arsimit nuk po harton plane afat gjatë për edukimin e filizave të rinj?

Nga një studim që kemi kryer një grup ekspertësh auto-teknik në aksin rrugor Fushë Krujë-Shkodër na rezultoi që rruga është e pajisur me sinjalistikën horizontale vertikale për qarkullim, por drejtuesit e mjeteve nuk e zbatojnë atë, vallë pse? Sepse ne si shqiptarë nuk jemi të formuar me edukatën rrugore dhe kemi qef t'i shkelim rregullat e qarkullimit rrugor madje dhe kur shohim një punonjës të policisë rrugore themi: Doli ky dreq, pa e kuptuar që ai punonjës

Për të mos vajtuar më



punon për të ruajtur jetët tona për të ruajtur fëmijët tanë që çdo ditë janë të kërcënuar nga shkelësit e rrugës nga ata që pa e kuptuar

kthehen në vrasës dhe më pas thonë: Si ndodhi?

Nuk i uroj kurrujt që t'i ndodhi aksidenti rrugor pasi ai është

një traumë për të gjitha palët e përfshira në të.

Mendoj që e vetmja forcë që po operon në rrugë për parandalimin e aksidenteve rrugore është Policia Rrugore, por edhe ajo ka vështirësitë e veta, ka ardhur koha që dhe kjo polici të ketë një organizim tjetër, perse mos të jemi edhe ne si shtetet e "BE"-së. Duke u pajisur me një strukturë të veçantë me shtrirje në gjithë rajonin e vendit, e cila të varet direkt nga ministri i Punëve të Brendshme dhe të raportojë çdo muaj te kryeministri i vendit për rezultatet e arritura në vend dhe vështirësitë që hasin në ushtrimin e detyrës. Besoj se kjo strukturë nuk ka kosto ka vetëm një riorganizim, sepse njerëzit janë, Policia Rrugore është, duhen vetëm disa kritere për të punuar në këtë strukturë.

Siç e thoshte i madhi Sun Tzu, nëse në mendje ekziston dëshira, gjithçka mund të realizohet. Pra, edhe në Shqipëri në mund t'ia dalim që të ecim të qetë dhe nën shenjën e sigurisë rrugore në sigurinë e jetës, së jetës së fëmijëve tanë në respektin e atyre që kanë humbur jetën dhe i nënave, të cilat kujtojnë e vajtojnë për fëmijët e tyre të cilët humbë n jetën në rrugë. I përjetshëm qoftë kujtimi i viktimitave të pafajshme të aksidenteve!

Reportazhi *i* Ditës

Sulmi në xhami vret 230 myslimanë në Egjipt

(Vijon nga faqja e parë)

... Bir al-Abd dhe se së paku 120 persona të tjerë janë plagosur.

Mësohet se sulmuesit kanë shpërthyer eksplozivë, përpara se të qëllonin besimtarët brenda xhamisë, që falnin Xhuanë.

Qeveria ka shpallur tri ditë zie. Televizioni shtetëror raportoi se presidenti i Egjiptit, Abdel Fattah al-Sisi, ka thirrur takim urgjent të sigurisë, menjëherë pas sulmit. Pamjet nga vendi i ngjarjes tregojnë viktima të mbuluara me gjak brenda xhamisë.

"Ata (v.j. sulmuesit) kanë qëlluar njerëz edhe teksa largoheshin nga xhamia, kanë qëlluar edhe auto-ambulancat", tha një dëshmitar për agjencinë Reuters. Banorët lokalë citohe të kenë thënë se në xhaminë e sulmuar zakonisht mblidhen ndjekës të Sufizmit apo misticizmit islamik. Disa grupe xhihadiste, përfshirë të ashtuquajturin Shtet Islamik, i shohin ata si të pafe.

Militantët islamikë janë çuar në kryengritje në Gadishullin Sinai që prej disa vitesh. Ata i kanë intensifikuar sulmet ngaqë ushtria e Egjiptit ka rrethuar nga pushteti presidentin islamik, Mohammed Morsi, pas protestave masive antiqeveritare, në korrik



të vitit 2013.

Qindra policë, ushtarë dhe civilë janë vrarë që atëherë, kryesisht në sulme të kryera nga Grupi i Provincës Sinai, që është i lidhur me Shtetin Islamik.

Grupi i Provincës Sinai ka kryer, po ashtu, sulme vdekjeprurëse kundër pakicës së krishterë kopte të Egjiptit, gjatë në këtë vend. Ai, po ashtu, ka thënë se ka sulmuar një avion rus, që transportonte tur-

ist në Sinai, në vitin 2015, duke vrarë të 224 njerëzit në bord.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, tha se sulmi i së premtes në Sinai është "i tmerrshëm dhe frikacak".

HOROSKOPI

DASHI

Me Venusin që ju mbështet, shfrytëzoni çastin e mirëngjes shpirtërore për të dëgjuar më shumë dhe për t'i kushtuar më shumë kohë familjes. Me Saturnin që ju del kundra, priten disa përgjegjësi që ndoshta mund t'ju kufizojnë disi lirinë.

DEMI

Nëse keni programuar një udhëtim, do ta menaxhoni më mirë lodhjen dhe përshtatjen ndaj rritmeve më të mëdha të punës, falë Jupiterit mik i Peshores. Kridhuni në ndonjë aventurë të bukur, zbuloni një horizont të ri dhe jetojni me gjithë shpirt.

BINJAKET

Disa kërkesa për pushtet në çift nuk funksionojnë. Hapni rrugë. Nëse do të jeni më mirënjohës, rezultatet nuk do të vonojnë të vijnë. Mos u merrni me gjëra që hanë diskutim. Duke këmbëngulur, do ta kuptoni se e keni pasur gabim.

GAFORJA

Me ndikimin e Saturnit mund t'ju dalin gjëra të paparashikueshme. Për të shmangur tensione, ndiqni atë që ju thotë zemra, edhe pse mund të interpretohet si një dëbësi. Do të keni një ditë që priret drejt përtaçisë, por që nuk pajtohet me angazhimet tuaja të shumta.

LUANI

Keni shumë pritshmëri ndaj një personi që ndoshta nuk do të tregohet në lartësinë e duhur. Do të ishte mirë ta përdorni vëmendjen dikujt tjetër. Mos u bëni kokëfortë! Keni dëshirë të madhe të imponohet në të gjitha rrethanat. Do të ishte mirë që edhe të mendoheshit pak për veprimet që ndërmerrni.

VIRGJERESHA

Partneri më në fund do të jetë në lartësinë e duhur që kërkoni situata dhe nuk do të shqetësohet nga përgjigjet që do t'ju jepni kërkesave që ka. Nëse do të zgjidhni të jeni më emocional, do të jeni më pak bujar dhe të përfshirë, por me siguri më të qartë dhe të qetë.

PESHORJA

Nëse në jetën e në çift xhelozia dhe dyshimet do t'i kalonin nivelet e normales, jepini fund kur të mundeni dhe ndërroni menjëherë drejtimin Jupiteri në qiellin tuaj i kundërvihet Hënës. Humori jo i mirë do të pengojë bashkëpunimin me një koleg.

AKREPI

Të papritura të këndshme në familje. Përditshmëria do të jetë më emocionuese dhe e këndshme, edhe pse do t'ju ndodhë që të ndryshoni menjëherë programin. Do të jeni në lartësinë e duhur për të marrë vendime shumë delikate. Do të fitoni kështu vlerësimin e një eprori.

SHIGJETARI

Me Mërkurin kundër jush, mos flisni shumë në ambientin e punës. Mos krijoni konfidencë. Mundohuni të mos tregoni sesi ndiheni. Mos u ndruani dhe thoni ato që ju thotë zemra, edhe pse keni frikë se personi i dashur përkrah jush mund të mos ju kuptojë.

BRICJAPI

Me një Hënë të bukur që ju mbështet, do të mposhtni çdo mendim shkatërrimtar, do të përvishni mëngët dhe do të përmblusni me zell punët që keni. Në fillim kush ju intereson do t'i përgjigjet ftesës me droje, por më pas do të dorëzohet nga sharmi juaj.

UJORI

Edhe pse dini të manovroni më së miri duke u mbështetur në vetvete, mos e refuzoni ndihmën që do të bjerë nga qielli falë një mikut. Do të kërkoni dhe do të gjeni, me Venusin dhe Mërkurin në harmoni, mundësi dialogu dhe bashkëpunimi me personin e dashur.

PESHQIT

Hëna në shenjën tuaj është shënjestruar nga shumë anë dhe për rrjedhojë h do të ketë luhate humor. Mos u mbyllni brenda vetes. Pranoi dhe besojini të tjerëve. Për të arritur në një mirëkuptim më të madh, vëreni veten në vendin e partnerit dhe bëni më të mirën që mundni.

TROFEU I GOLASHËNUESIT



Lionel Messi mori këtë të premtë trofeun e "Këpucës së Artë", çmim të cilin e fitoi për herë të katërt në karrierë, pasi u shpall golashënuesi më i mirë në Europë. "Pleshti" shënoi 37 gola sezonin e kaluar në La Liga, duke barazuar edhe kundërshtarin e tij të përjetshëm,

Mesi fiton "Këpucën e Artë", barazon Ronaldon

Kristiano Ronaldo, me këtë trofe individual. Pasi mori edhe çmimin, Messi u shpreh: "Jam përmirësuar shumë në lojën time. I kam shtuar elementë të rinj repertorit tim. E them gjithmonë, se çmimet individuale

vijnë prej punës në grup. Nuk do e fitoja dot pa ndihmën e madhe të shokëve të skuadrës. E shijoj çdo ditë e më shumë faktin që jam një futbollist". Për faktin që e nisi nga stoli ndeshjen e mesjavës në Champions ndaj Ju-

ventusit, argentinasi shoi: "Gjithmonë bën bujë lajmi kur unë jam në stol. Është e vërtetë që nuk më pëlqen të jem jashtë skuadrës, dua të ndihmoj shokët në fushë, por jam i vetëdijshëm për faktin se sezoni është i gjatë dhe duhet të kujdesem për veten".

Trajneri rrëfen në një intervistë jetën në Korçë dhe shijen që po i lënë sukseset në Europë

Tani të gjithë e njohin si trajnerin më të suksesshëm me një ekip shqiptar, pasi këtë sezon ka thyer çdo rekord me Skënderbeun. Si askush tjetër, ka kaluar 4 ture në kompeticionet europiane, ka mposhtur skuadra me emër në Europë dhe ka 5 pikë në grupet e Europa League. Skënderbeu ka një profil të veçantë loje, të portretizuar me emrin e Ilir Dajës. Në një intervistë për "Vipsport.al", Ilir Daja rrëfen anën e panjohur, atë jashtë fushës së blertë.

Për të gjithë ata që nuk ju njohin, kush është Ilir Daja jashtë fushës?

Një person si të gjithë të tjerët. Zakonshëm, me profesionin që merr gjithë kohën dhe ku impenjimi është maksimal. Thua se gjithë kohën ma merr përgatitja e materialit, pasioni për futbollin.

Në atë pak kohë që ju mbetet profesor, çfarë preferoni të bëni?

Kur kam ndonjë ditë pushim, preferoj të udhëtoj, të dal jashtë qytetit të Korçës, në vendet e tij të bukura. Kaloj kohë me miq e shokë. Bashkë me pjesëtarët e stafit tim, pra me shoqërinë e punës, rrimë bashkë në darkë dhe pimë edhe ndonjë gotë verë. Kjo është edhe pjesa ime e preferuar.

A jeni familjarizuar tashmë me Korçën?

Korça është nga qytetet më të këndshme të Shqipërisë, ka edukatën dhe kulturën. Ka një traditë shumë të mirë në gatim, jo vetëm atë vendëse, pasi ka shumë kuzhinierë, të cilët kanë punuar në vendet fqinje dhe kanë marrë shumë përvojë. Ka larmi gatimesh.

Pjata juaj e preferuar?

Jam me shumë të gjërat tradicionale. Për shembull, qoftë me kungulleshka më pëlqejnë shumë. Edhe pastat, makaronat apo dhe gatimet e mishit.

Ku banoni në Korçë?

E kam shtëpinë 100 metra larg stadiumit, shumë afër. Tani në dimër më pëlqen shumë soba e drurit që kam në shtëpi. Është shumë e këndshme.

Çfarë makine keni?

Një "Mercedes", por mos më pyesni për vitin e prodhimit... Jam shumë i kënaqur për atë, por them se ka ardhur koha ta ndërroj. Përsëri do të marr një "Benz"

Ilir Daja: Me shpërblimin do blej një makinë të re
Tekniku kryeqytetas rrëfëhet në "360 gradë"

ose një "BMW".

Do t'i shpenzoni për makinën e re premlot e ndeshjeve europiane?

Po, ia vlen të pasur një makinë të re me premlot që kemi marrë gjatë kësaj kohe.

Gatunat?

Të them të drejtën, e porosis me telefon ushqimin. Në përgjithësi, preferoj të dal jashtë, por kur e kam kohën të limituar, porosis me telefon.

Jeni kursimtar apo shpenzoni?

Nuk më ngjit leku fare. Shpenzoj shumë, edhe pse Ilir Bozhilqi më thotë se jam kurnac.

Jeni miq prej kohësh me profesor Ilir Bozhilqin. Ia keni kopjuar ju modelin e flokëve apo ai juve?

(Qesh) Jemi shokë prej 30 vitesh, por nuk kemi të njëjtë modelin e flokëve. Ai i mban me vijë në mes, unë



nuk i kam mbajtur asnjëherë kështu.

Cilat gjuhë të huaja flisni?

Flas italisht dhe anglisht, por këtu më duhet të pranoj se është pika ime e dobët, sepse nuk kam mbrojtur me

dëshmi asnjëherë prej tyre. I flas, por jo deri në atë pikë sa të komunikoj sa më duhet në profesionin tim. Kur i kthehem vetes, e kam "peng" gjuhën, sepse kam pasur ofertë edhe nga jashtë. Komunikimi është shumë i rëndësishëm, pasi unë jam një trajner demokrat, ku rregulli është primar. Dua që lojtarët të jenë të bindur për atë që bëjnë, jo të urdhëruar. I lë lojtarët në seanca teorike të debatohen me argumente.

Për çfarë oferte bëhet flalë konkretisht?

Para 3 vjetësh kam pasur një ofertë nga Arabia Saudite, por nuk më pëlqen të punoj me përktës. Kam pasur një ofertë edhe nga Shkëndija e Tetovës.

Çfarë ndodh me akademinë tuaj?

Akademia vazhdon punën e saj, por atë pjesë që

më takon ia kam lënë tim biri, i cili ka edhe licencën e duhur.

Modeli juaj në trajnim?

Për nga mënyra e të luajturit më pëlqen Guardiola. Më pëlqen spektakli dhe loja sulmuese.

Mesi apo Ronaldo?

Do të zgjidhja idealin. Mesi është talent natyral, kurse Ronaldo është talent dhe shumë punë. Është një shembull shumë i mirë, pasi pavarësisht emrit që ka, ai vazhdon të punojë njësoj.

Keni punuar në disa skuadra, keni ndonjë moment që do të donit ta veçonit?

Për mua, një moment i paharrueshëm është ai me Elbasanin në vitin 2005-2006. Kemi qenë kryesues nga java e parë deri në fund. Festimi i atij titulli ka qenë një përjetim i paparë. Më parë kisha punuar te Pogradeci në Kategorinë e Parë, ku arritëm objektivin e mbijetesës. Në vitin 2008, pasi punova një vit si drejtor teknik, dolëm kampionë me Dinamon. Kujtoj finalen me Partizanin javën e fundit, që e gjykoj Taljaven-tu. Luajtëm me 9 vetë dhe fituam. Pastaj kam qenë 2 herë të Besa. Herën e dytë kisha një ekip shumë simpantik, ku 6-7 lojtarë luanin për herë të parë në Superiore dhe ishin të rinj në moshë. Ishte Fejzullahu 19 vjeç, Batha 20, Dita, Berisha, Mustafa. Tirana ishte një kënaqësi më vete, por diferencën e bën pa dyshim Skënderbeu. Jo se jam unë të ky ekip, por ky klub ka një potencial shumë të madh, kushte shumë të mira për të punuar dhe një organizim perfekt.


Çfarë raporti keni me lojtarët?

Jam trajner kërkues në stërvitje, por kam raporte shumë të mira, jo vetëm me lojtarët që kam aktualisht në ekip, por me të gjithë të tjerët, duke përfshirë edhe ndonjë rast. Thonë gjithmonë se në një ekip ka një lojtar, të cilin e quajnë "çuni i presorit". Te Skënderbeu për shembull, Lilaj ngacmon Vangjelin: "Hë mo çuni i presorit"... Ka një shprehje nga një trajner gjerman, i cili ka thënë: "Dua që 50% e lojtarëve të më duan, 30% të më respektojnë dhe 20% të më urrejnë". Flas me të gjithë futbollistët që kam pasur, përveç Bledar Devollit.

SULMUESI

Nga Kalabria në Europa League, historia e Soue bën bujë në Itali

Alli Soue është bërë protagonist në pak kohë te skuadra e Skënderbeut. Sulmuesi i fuqishëm nga Gambia ka tërhequr vëmendjen e mediave italiane, të cilat shkruajnë për rritjen e madhe që ka pësuar në një kohë të shkurtër. Futbollisti në pronësinë e ekipit të Kievos gjatë këtij viti është huazuar në vitin 2017 fillimisht te Valbonesë në Seria C, ndërkohë që tashmë është pjesë e Kategorisë Superiore, si dhe e Europa League, ku ka shënuar edhe dy gola. Pas golit të realizuar ndaj Jong Boys në barazim 1-1 më 28 shtator, Soue gjeti rrugën e rrjetës edhe ndaj Dinamos së Kievit. Fillimisht ai dha një asist për shokun e skuadrës në golin e dytë, ndërkohë që më pas ktheu në gol një pasim fantastik të Gavazajt.



[BONESE CALCIO] Dalla Calabria in Europa League: la storia di Alli Soue


TREMBEN KOMPANITË E BASTEVE

PSG kuotohet si favoritja kryesore për të fituar Championsin

Mbrëmjen e së mërkurës, Sëlltiku pësoi një nga disfatat më të rënda të historisë në Champions dhe shkaku ishte PSG-ja. Fitorja me goleadën 7-1, e dërgoi në 24 numrin e golave të shënuar nga Nejmar me shokë, pas vetëm 5 ndeshjesh (rekord historik në këtë fazë) dhe 'makineria' perfekte e ndërtuar nga Unai Emery ka nisur t'i trembë të gjithë, edhe kompanitë e basteve: triumfi i tyre në finalen e këtij edicioni kuotohet me koeficientin 4,50. Ata ndiqen nga Manchester Siti me 5,50, kampionët në fuqi të Realit të Madridit me 6,50, Barcelona (7,50) dhe Bajerni (8,50).



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Ooole aktor
- Si vizuale.
- Në fund të lutjes.
- Janë popullsi e qytetit
- Një pije freskuese.
- Eshhtë enjije.
- Teke prizje.
- Janë mallkime shkishëruese.
- Një aftësi paranormale.
- Janë fakultetet më me leverdi.
- Gjëja e romakëve.
- Thahen me bonifikim.
- Zemeckis regjisor
- Janë në temë
- Inicialet e Harris aktor.
- Eshhtë figurë gjeometrike.
- Një markë makine qepëse.
- Kush ka... ka zët.
- Mbyllin komentin.
- I bëhen të gjitha mikut.

VERTIKAL

- Fillojnë panikun.
- Ai i trëndafilit është i Umberto Eco-s.
- Në krye të tenorëve.
- Mund të jetë gjaku dhe kuzhine.
- Inicialet e Anka këngëtar.
- Kush ka... ka nevojë për gjak
- Ndiqet ajo e fundit
- Duken të gjata në pritje.
- Një fazë gjumi.
- Shteti i francezëve
- Një art i shtatë.
- Eshhtë pellgu.
- Shkroi Pa familje
- Janë dokumente shtëpie.
- Eshhtë filmi që mallëngjen.
- Një koleg anglez.
- Janë baballarët.
- Mund të jetë elektrike.
- Eshhtë hidrofofi.
- Ajo e forcës është për të çmendur.
- Kremit pa ekstreme.
- Si sezonale.
- Mund të jenë unike
- Mund të jenë periodike të tilla.
- Eshhtë bishë që zgërdhohet.
- Fillojnë nazet
- Inicialet e Diamanti aktore.
- Eshhtë mosha më e bukur.
- Fillojnë temën.
- Kufizojnë një send.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL

- Një film publicitar
- Në krye të bashkisë.
- Me Romeo në makinë
- Në fund majtas
- Janë kompozime si Vejusha gazmore
- Janë në masë.
- Janë melodrama.
- Fillojnë dobët.
- Në hyrje të radios.
- Një pjesë e lipotimisë.
- Eshhtë gjendje të fikti.
- Eshhtë vërtet i mërztishëm.
- Maiden që këndojnë
- Hurley aktore.
- Pak torturuese.
- Ekstreme në tunel.
- Ndezur në aparatet.
- Ai i shenjtë është papa.
- Merrte fuqi nga toka.
- Pak enigmatike.


VERTIKAL

- Oe mbreti i parë i Izraelit.
- Post scriptum
- Një sferë... për model.
- Eshhtë infeksion në bark
- Një mund të jetë arme.
- Në krye të atletëve.
- Eshhtë grimcë me bërthamë.
- Ishte sundimtar si Tutankamon
- Masat pa kufij
- Një sport bashkësh.
- Janë marrëdhënie.
- Padia pa kufij.
- Eshhtë në minorancë.
- I ka shumë të goditura Agron Llakaj.
- Kështu janë lojtarë te formaconit
- Janë të holla dhe therëse.
- Makinë ruse.
- Eshhtë dita e dytë
- Bisha aktore
- Në mes të rrugës.
- Një trup pa kënde.
- Satie kompozitor.
- I ka të ndryshme një sakat.
- King Cole i muzikës.
- Inicialet e Penn aktor.
- Në mes të dhomës.
- Të fundit në spital.




- Oe mbreti i parë i Izraelit.
- Post scriptum
- Një sferë... për model.
- Eshhtë infeksion në bark
- Një mund të jetë arme.
- Në krye të atletëve.
- Eshhtë grimcë me bërthamë.
- Ishte sundimtar si Tutankamon
- Masat pa kufij
- Një sport bashkësh.
- Janë marrëdhënie.
- Padia pa kufij.
- Eshhtë në minorancë.
- I ka shumë të goditura Agron Llakaj.
- Kështu janë lojtarë te formaconit
- Janë të holla dhe therëse.
- Makinë ruse.
- Eshhtë dita e dytë
- Bisha aktore
- Në mes të rrugës.
- Një trup pa kënde.
- Satie kompozitor.
- I ka të ndryshme një sakat.
- King Cole i muzikës.
- Inicialet e Penn aktor.
- Në mes të dhomës.
- Të fundit në spital.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		2			3	4		
9		7	8	1			6	
	6	2	9			7		
7	5				2	1		
8			6		5			3
		4	3				2	7
		9			6	8	5	
	3			4	9	6		1
5	1				8			

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	2	4	1	5	8	7	6	9
6	1	5	7	9	4	8	2	3
8	7	9	6	3	2	5	4	1
9	8	6	5	7	1	4	3	2
7	5	2	3	4	9	6	1	8
1	4	3	2	8	6	9	5	7
4	6	1	9	2	7	3	8	5
2	3	7	8	6	5	1	9	4
5	9	8	4	1	3	2	7	6

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Virtyti ashtu si ari që të jetë i përdorshëm, duhet të përzihet me ndonjë metal tjetër me më pak vlerë, por më të fortë. (Samuel Butler)
- Shenjtorët janë mëkatarët që vazhdojnë të përpiqen gjithnjë. (Robert Luis Stivenson)
- Një njeri i zgjuar e vendos gjithnjë veten në anën e kundërshtarëve të tij. Eshhtë më tepër në interes të tij, se sa të atyre, që të gjejë pikat e tij të dobëta. (Ralf Valdo Emerson)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

15	D	1	7	2	3	1	4	2	17	6	2	4	M	I	K	E	K	M	S	E				
6	O	2	3	10	11		17	4	9	3	2		E	K	A		R	O	M	A	K	E	T	
17	B	7	8	6	9	6	13	4	6		17	7	K	M	I	L	I	T	A	N	T	E	T	
	I	11	7	2	6	1	4	2		2	4	8	M	A	T	E	M	A	T	I	K	A		
18	3	1	4	12		4	1	4		1	3	2	P	A	S	A	N	I	K	T		S		
2	3	12	2	3	12	3	3	3	16	1	3	3	E	K	U	T	A	N	E	T	A	R	E	T
	16	3			4	15		16	2	7			R	E	T	E	E	I	R	A	N	I		
15		2	4	8	16	2		12	7	2	4	2	I	T	R	E	B	L	A	K	E		L	
4	18		1	1	7		8	7	9	6	13	7	M	I	A	R	E	D		E	K	I		
12	7	1	7	3	12		8	1	4	1	4	2	E		M	E	T	A	L	E		I	S	
7	2	3		10	7	3		3	2	7		6	T	E	K	E		M	K	U	M	T		
													M	O	R	A	V	I	A		M	A	E	

Thënie të mençura

- I thashë Zotit, "Më ruaj nga armiqtë" dhe fillova të humbas miqtë...
- Mos akuzo njerëzit për zhgënjimet e tua, akuzo veteveten që ke pritur shumë nga njerëz që s'duhej të prisje asgjë.
- "Kur të ketë kaluar stuhia, nuk do të mbash mend se si ja dole apo si mbijetove. As nuk do të jesh i sigurt nëse stuhia ka kaluar me të vërtetë. Një gjë e vetme është e sigurtë. Sapo të ketë kaluar stuhia, ti nuk do të jesh më kurrë i njëjti person me atë që ishe para se të fillonte stuhia." Haruki Murakami

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

A	R	K	A	A	S	T	R	O	A	M	A	
D	I	A	N	A	H	A	N	T	I	K		
A	T	L	A	N	T	I	K	E	O	L	S	
P	E	I	T	A	R	I	F	A	T	L	E	
T	T	P	O	L	I	T	I	K	A	N	E	T
		K	E	N	E	T	A	O	R	A	R	T
P	A	U	L	I	N	A	R	D	R	I		
A	K	E	O	T	A	A	D	I	D	I	M	
R	U	M	U	N	E	K	T	E	R	A	N	
E	T	I	T	E	R	I	A	M	A	N		
T	E	I	G	O	R	D	I	A	N	E		
I	N	T	A	R	O	M	A	T	E	I	T	

FJALËKRYQI (2)

P	A	B	M	E	L	E	R	G	O			
A	R	K	U	P	A	E	M	I	R	A	T	E
O	H	A	R	A	D	A	R	O	M	A	T	
C	I	K	L	I	S	T	E	T				
S	T	A	D	I	U	M	E	T	A	P	E	L
D	I	K	A	S	T	E	R	E	R	U	E	
K	E	N	T	N	G	O	P	J	E	V		
K	A	T	I	A	S	I	E	S	E			
A	R	N	I	O	L	A	T	R				
A	M	S	I	M	O	Z	A	N	O	R	E	
A	M	A	N	A	N	A	N	N				
T	I	E	R	E	N	T	E	I	T			

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

